

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE  
DHE KOMUNIKIMIT  
GJUHË, KULTURË DHE LETËRSI SHQIPE

## STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

### **POZITA E FEMRËS DHE ASPEKTI SOCIAL NË PROZAT E MIGJENIT**

KANDIDAT:

Afërdita Seferi

MENTOR:

Doc. dr. Meral Veseli

Tetovë, Maj 2020

## DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Afërdita Seferi, studente në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Europës Juglindore- Tetovë, deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e të njejtit.

Afërdita Seferi

---

Lektoroi:

Doc.dr. Luljeta Adili-Çeliku

---

## ***FALEMINDERIME***

***Fillimisht dua të faleminderoj stafin e Universitetit të Evropës Juglindore në përgjithësi, i cili kontriboi në avancimin tim profesional.***

***Falenderim të veçantë edhe për udhëheqesen shkencore të tezës sime Doc. dr. Meral Veseli, e cila më ndihmoi në realizimin e këtij punimi.***

***Poashtu, një falenderim të veçantë edhe për profesorët, anëtarët e komisionit të cilët pa asnjë hezitim më ndihmuan në arritjet e mia profesionale.***

***Dhe së fundi faleminderim më të rëndësishëm për familjen time, e cila më ka përkrahur gjatë gjithë kohës.***

# Përmbajtja

|                                                                                       |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------|----|
| ABSTRACT.....                                                                         | 6  |
| АПСІТАКТ .....                                                                        | 7  |
| Arsyetimi social dhe shkencor i tezës së masterit .....                               | 8  |
| Lënda e hulumtimit e tezës së masterit.....                                           | 9  |
| Kuadri hipotetik dhe metodat e hulumtimit .....                                       | 10 |
| KAPITULLI I .....                                                                     | 11 |
| I. ASPEKTE HISTORIKE TË PROZËS SË MIGJENIT .....                                      | 11 |
| I.1. Përiudha letrare në kohën e Migjenit .....                                       | 13 |
| I. 2. Momente historike dhe shoqërore në kohën e Migjenit .....                       | 14 |
| I. 3. Gruaja shqiptare në kontekstin e prozës së Migjenit .....                       | 19 |
| KAPITULLI II .....                                                                    | 21 |
| II.GRUAJA SHQIPTARE DHE ROLI I SAJ NË JETËN SHOQËRORE.....                            | 21 |
| II. 1. Gruaja shqiptare e shekullit XIX.....                                          | 22 |
| II. 2. Perceptimet shoqërore të gruas shqiptare nëpër fazat e zhvillimit letrar ..... | 23 |
| II.3. Roli i gruas shqiptare në jetën shoqërore në atë kohë .....                     | 28 |
| KAPITULLI III.....                                                                    | 31 |
| III. GRUAJA SHQIPTARE SOT.....                                                        | 31 |
| III. 1. Dallimet e shprehura në jetën shoqërore sipas Migjenit atëherë dhe tani ..... | 33 |
| III.2. Kuadri shoqëror i ndryshimit për gratë shqiptare .....                         | 36 |
| KAPITULLI IV.....                                                                     | 41 |
| IV. GJENDJA SOCIALE NË KOHËN E MIGJENIT .....                                         | 41 |
| IV.1. Pasqyrimi i gjendjes sociale në prozë .....                                     | 44 |
| IV.2. Poema e Mjerimit dhe realiteti .....                                            | 45 |
| IV.3. Migjeni dhe autorët ku mbështetet për frymëzim .....                            | 50 |
| VËZHGIME PËRFUNDIMTARE.....                                                           | 52 |
| BIBIOGRAFIA.....                                                                      | 55 |
| BURIME NGA INTERNETI: .....                                                           | 57 |

# ABSTRAKT

Në këtë punim shqyrtohet pozita e gruas shqiptare në kohën e Migjenit. Si një nga shkrimtarët më të shquar të letërsisë, përmes një rrëfimi historik krahasues përshkruan pozicionin e gruas në periudhën e tij, ndryshimet dhe dallimet e jetës shoqërore atëherë dhe tani. Krahasimi i gruas në epokën e Migjenit dhe pozicioni i saj sot pas globalizimit, lirinë e shprehjes, jeta jo patriarkale në ditët e sotme, tendencat e jetës moderne, pavarësia financiare, roli i gruas në jetën publike, menaxhimi shoqëror, niveli i arsimit atëherë dhe tani si pjesë krahasuese me pikëpamjet e Migjenit.

Shkurtimisht përshkruhet roli i gruas shqiptare i shprehur në prozën e Migjenit, prezantohet gruaja shqiptare dhe krahasohet mënyra aktuale dhe jeta shoqërore e asaj kohe. Gjithashtu, shqyrtohen dhe aspektet sociale në kohën e autorit duke bërë një krahasim të gjendjes sociale dhe ekonomike nga koha kur Migjeni jetoi dhe veçoi me kohën e sotme prej së cilave vijmë në përfundim që Migjeni shpalli protestë të hapur ideoartistike dhe prezantoi ëndrrën e tij për një botë të re duke e shpalosur optimizmin e thellë që ai ka poseduar.

Ai e pasqyroi shoqërinë e kohës së vet, por duke e gjykuar dhe dënuar, në emër të një të ardhmje më të bukur. Duke kritikuar haptazi thelbin tragjik të botës shqiptare shohim qartë që individi filloi të vështrohej më gjerë në raport me jetën politiko-shoqërore.

**Fjalët çelës: Migjeni, femra shqiptare, gjendja sociale, gjendja ekonomike**

## ABSTRACT

This master thesis examines the position of the Albanian woman in the time of Migjeni. As one of the foremost writers of Albanian literature, through a comparative historical narrative describes the position of women in his period, the changes and differences of social life then and now. Comparison of women in the Migjeni era and the position of women today after globalization, freedom of expression, non-patriarchal life today, modern life trends, financial independence, women's role in public life, social management, education level then and now , as a comparison with the views of the author Migjeni.

We briefly describe the role of the Albanian woman expressed in the prose of the author Migjeni, introduce the Albanian woman and compare the current way and social life of that time. This thesis also examines the social aspects of the author's time by comparing the social and economic situation from the time Migjeni lived and wrote, with the present time, from which we conclude that Migjeni declared open protest and presented his dream of a new world by revealing the profound optimism he possessed. He reflected the society of his time, but judging and condemning it, in the name of a more beautiful future.

By openly criticizing the tragic essence of the Albanian world, we can clearly see that the individual began to be seen more broadly in relation with political and social life.

**Key words:** Migjeni, Albanian Woman, Social status, Economic status.

## АПСТРАКТ

Во оваа магистерска теза се разгледува положбата на албанската жена во времето на Миѓени. Како еден од најистакнатите писатели на албанската литература, преку компаративен историски наратив ја опишува положбата на жената во неговиот период, промените и разликите во општествениот живот тогаш и сега. Споредба на жените во ерата на Миѓени и положбата на жените денес по глобализацијата, слободата на изразување, непатријархалниот живот денес, современите животни трендови, финансиската независност, улогата на жените во јавниот живот, социјалниот менаџмент, нивото на образование тогаш и сега, како споредба со ставовите на авторот Миѓени.

Накратко ја опишуваме улогата на албанската жена изразена во прозата на авторот Миѓени, ја запознаваме и го споредуваме социјалниот живот сега и во тоа време. Оваа теза ги испитува и социјалните аспекти на времето на авторот со споредување на социјалната и економската состојба од времето кога живеел и пишувал, со сегашноста, од каде заклучуваме дека Миѓени прогласил отворен протест, претставувајќи го својот сон за нов свет, откривајќи го длабокиот оптимизам што го поседувал.

Тој го претстави општеството од своето време, но судејќи го и осудувајќи го, во име на поубава иднина. Со отворено критикување на трагичната суштина на албанскиот свет, јасно можеме да видиме дека поединецот започна да се гледа пошироко, во врска со политичкиот и социјалниот живот.

**Клучни зборови:** Миѓени, албанска жена, социален статус, економски статус

## **Arsyetimi social dhe shkencor i tezës së masterit**

Rëndësia e kësaj teze është para së gjithash, për pozitën e gruas, si një çështje letrare e përpunuar në mënyrë të pamjaftueshme sot e kësaj dite në trevën tonë, pastaj në fushën e shkencave shoqërore që shqyrton dhe përcepton ndryshimin global shoqëror, veçanërisht në aspektet e rolit të gruas si një segment dhe një udhëheqës në një plan mikro dhe makro social.

Qëllim i këtij studimi është ndriçimi i figurës dhe pozitës së gruas shqiptare në periudhën kur jetoi dhe veproi Migjeni.

Krahasimi i gruas në epokën e Migjenit dhe pozicioni i gruas sot (globalizimi, liria e shprehjes, jeta jo-patriarkale në ditët e sotme, tendencat e jetës moderne, pavarësia financiare, roli i grave në jetën publike, menaxhimi shoqëror, niveli i arsimit atëherë dhe tani, etj.), si pjesë krahasuese me pikëpamjet e Migjenit.

Krahasimi i gjendjes sociale dhe ekonomike nga koha kur Migjeni jetoi dhe veproi me kohën në të cilën jetojmë ne.



## **Lënda e hulumtimit e tezës së masterit**

Tema e hulumtimit e kësaj teze masteri merret me aspektin historik dhe letrar të aspekteve shoqërore dhe sociale të gruas në shoqërinë shqiptare në kohën e krijimit të veprës së autorit, Migjeni. Në këtë tezë përmes një rrëfimi historik krahasues do të përshkruajmë pozicionin e gruas në periudhën e Migjenit, ndryshimet dhe dallimet e jetës shoqërore atëherë dhe tani, si dhe një përmbledhje hipotetike të asaj që presim në të ardhmen e afërt.

Si temë bazë e veprimtarisë së Migjenit është tema sociale e varfërisë, aspirata për një botë të re në të cilën njerëzit e thjeshtë do të jetojnë të lirë dhe të lumtur me dinjitet njerëzor dhe pa frikë për të nesërmen, dhe po asaj do t'i japim rëndësinë e merituar duke e analizuar dhe prezantuar në këtë studim.

Në krijimtarinë e tij letrare problematika sociale është më e përhapur gjë e cila kishte munguar për ne dhe studimet tona, në veprën e tij gjejmë vuajtje, revoltë, kritikë dhe shpalosjen e jetës së mjerimit. Temat të cilat ai promovoi në letërsi ishin tabu për kohën në të cilën autori ka jetuar, siç ishin: ajo e prostitucionit, homoseksualizmi dhe erotika.

## Kuadri hipotetik dhe metodat e hulumtimit

**Hipoteza kryesore:** Pozita e gruas dhe jeta shoqërore në prozën e Migjenit.

**Hipotezë speciale:** Gruaja shqiptare në kohën e Migjenit dhe tani.

**Qëllimi specifik:** Vallë ka apo jo dallime drastike në pozicionin e gruas shqiptare atëherë dhe tani.

**Treguesit e hulumtimit:** Mbledhja e të dhënave për gjendjen shoqërore, ekonomike dhe politike në kohën e Migjenit. Analiza e pozitës së gruas në kohën e Migjenit dhe tani. Prezantimi i autorëve të cilët kanë shërbyer si frymëzim për Migjenin.

## Metodologjia dhe metodat e punës

Gjatë kërkimeve dhe gjatë hulumtimit të punës së tezës së masterit kemi përdorur disa metoda të cilat na kanë ndihmuar për të përfunduar tezën. Më së shumti është shfrytëzuar metoda analitike, metoda krahasuese si dhe metodat e induksionit dhe deduksionit.

**Metoda analitike** na jep një panoramë më të gjerë të pozitës së gruas atëherë dhe tani do të zbatohet si metoda kërkimore në këtë tezë master.

**Metoda krahasuese** e cila përmes veprës së Migjenit na përshkruan kontekstin ekonomik dhe politik të një gruaje të shprehur përmes prozës së tij.

Do të përdoren **metodat e induksionit dhe deduksionit**, metoda e analizës së përmbajtjes së dokumenteve të ndryshme që do të përdoren në këtë tezë master.

# KAPITULLI I

## I. ASPEKTE HISTORIKE TË PROZËS SË MIGJENIT

Në letërsinë evropiane pas romantizmit lindi realizmi i cili vuri në pah shumë padrejtësi themelore. Kur një drejtim lind, ai është proces i cili zhvillohet me ecurinë e shoqërisë, dhe ai proces është gjithmonë vazhdimësi e ecurisë letrare, pra hovit të ri që merr rryma letrare që gradualisht zëvendëson të vjetrën. Romantizmi në fazën fillestare të tij lindi kur klasicizmi ende vepronte si rrymë letrare.

Në gjysmën e parë të shek. XIX u shfaq realizmi, një rrymë e re letrare të cilën e ndoqën poetë të shquar të asaj kohe. Në krijimtarinë letrare poetët e realizmit e sollën gjendjen reale të shoqërisë. Këto shkrimtar, që vepruan dhe krijuan në rrymën e realizmit, quhen realistë. Përveç shkrimtarëve, duhet përmendur se poashtu vepruan edhe filozofë, sociologë dhe shumë të tjerë ku në lëminë e vet secili dha kontribut të madh. Fjala realizëm rrjedh nga fjala latine *re a l i s* që do të thotë e vërtetë, reale. Në letërsi fjala realizëm nënkupton drejtim letrar, epokë letrare.

Zgjedhjen e konflikteve rilindasit e shohin në sferën ideologjike dhe morale, ndërsa realistët, këtë problematikë e shohin në mënyrë reale në kuadër të zhvillimit të shoqërisë. Në vitet e 30-ta të shek. XIX, realizmi si drejtim paraqitet në Francë dhe pastaj përhapet në vendet tjera të Evropës. Realizmi zgjati deri në vitet 80-të shek. XIX, kur filluan të zhvillohen drejtime të tjera.

Zhvillimin më të hovshëm realizmi si drejtim i ri letrar e pati në Francë në fillim të shek. XIX, pastaj në Angli dhe Rusi. Në Itali, Gjermani dhe gati tërë shtetet tjera të Evropës realizmi u zhvillua me një tempo më të ngadalësuar, sepse këtu ende nuk ishte arritur shkalla e lartë e ndërgjegjësimit. Në këto shtete romantizmi zgjati më shumë. Honore De Balzak me veprën e tij “Komedia njërëzore” kishte ndikim më të madh në zhvillimin e realizmit, dhe për shumë shkrimtar ka qenë udhërrëfyes. Shkrimtari Stendali dhe dy veprat e tij: “E kuqja dhe e zeza” dhe “Manastiri i Parmës” janë veprat më të rëndësishme të shekullit dhe ky poet shkruan mu në këtë periudhë. Realizmin në letërsinë franceze për të cilin nuk ka temë të përshtatëshme apo të papërshtatëshme e vazhdon Gustav Floberi, i cili çdo gjë ka shndërruar në vepër arti dhe vepra e tij madhore është “Zonja Bovari”.

Në letërsinë angleze, në periudhën e realizmit, emër më i shquar ishte shkrimtari Çarls Dikens, i cili në veprën e vet si karakteristikë kryesore paraqet fatin e mirë si përfundim të veprat e tij. Në të njëjtën kohë me realizmin francez dhe anglez u paraqit edhe realizmi rus dhe si përfaqësues më të njohur kishte shkrimtarët: Aleksander Pushkin, Nikollaj V. Gogol, Ivan Turgeniev, Fjodor Dostojevski dhe Leon Tolstoi.

Fazat në të cilat është zhvilluar realizmi janë: - Realizmi i hershëm të cilin e përfaqësojnë: Balzaku, Dikensi, Gogoli. Kjo është faza e parë e cila shfaqet me shuarjen e romantizmit dhe si karakteristikë kryesore i ka komentet moralizuese. - Realizmi i zhvilluar si fazë e dytë merr hov pas vitit 1848. Këtë fazë e përfaqësojnë shkrimtarët: G. Flober, Thekeri, Turgenievi, Goncarovi, etj. ku personazhet bëhen vendimprurës të marrëdhënieve shoqërore. - Realizmi i lartë si faza e tretë, shfaqet si shuarje e realizmit dhe shfaqjen e drejtimeve të reja. Përfaqësues janë: L. Tolstoji dhe Dostojevski. Në realizëm shkrimtarët kanë shkruar vetëm për të vërtetën, realen dhe nuk janë nënshtruar ndjenjave personale.

Si Migjeni ashtu dhe shkrimtarët e tjerë të letërsisë moderne shqipe janë frymëzuar nga rrethanat sociale të kohës. Situatat tragjike të popullit shqiptar kanë frymëzuar Migjenin për të shkruar veprat e tij. Mosha dhe sëmundja e Migjenit janë ndihmësit kryesorë që e kanë përgatitur atë për të nxjerrë në pah mjerimin në të cilin kanë jetuar shqiptarët. Migjeni që në moshë të re i ka shikuar ngjarjet që e kanë rrethuar me një sy kritikues.

Kushtet sociale dhe sëmundja e tij kanë qenë faktorë të rëndësishëm dhe shtytës që poeti të dënojë këto dukuri me veprat e tij. Qosja mjerimin e sheh si faktor vendimtar për veprën e Migjenit. *“as Migjenit s’i asht përcjellë prej lindjes ndjenja e ferrit në shpirt, porse këtë ndjenjë ia kanë krijue rrethanat e përgjithshme shoqërore e posaçërisht skamja: ai lajtmotiv i krijimtarisë së tij”*<sup>1</sup>. Ai gjithashtu bindshëm tregon që mjerimi dhe skamja të cilën e përjeton edhe vet poeti, nga ato me siguri del një vepër e përkryer. Me vargun *“Mjerimi pjek fëmijë para se të burrhoet,*<sup>2</sup> Migjeni në mënyrë të pavetëdijshme e tregon ndikim e skamjes te moshatarët e vet, ngase edhe shumë fëmijë kanë qenë të detyruar të kërkojnë lëmoshë për të mbijetuar.

---

<sup>1</sup> Ali Aliu, *Kritikë*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 107-108

<sup>2</sup> Millosh Gjergj Nikolla, *"Vargjet e lira dhe novelat e qytetit të veriut"*, Migjeni, Tiranë, 2009, f. 12.

Jeta, mosha, sëmundja dhe mjerimi janë një zinxhir faktorësh të cilat i kanë krijuar “Vargjet e lira”.

Migjeni emërohet si kritiku më realist sepse në veprën e tij kritika dhe realizmi janë të përkryer. Migjeni shpeshherë personifikohet si mjerim për shkak se Migjeni dhe mjerimi janë shkrirë në njëri-tjetrin.

## **I.1. Përiudha letrare në kohën e Migjenit**

Migjeni ka lindur në Shkodër më 13 tetor 1911. Në vitin 1925, Migjeni fiton një bursë për të ndjekur shkollën e mesme të Manastirit në Maqedoni ku dhe studioi sllavishten e vjetër kishtare, rusishten, greqishten, latinishten dhe frengjishten. Në 1927 pasi e përfundon shkollën, hyn në Seminarin Ortodoks të Shën Gjon Theollogut, ku vazhdon studimet deri në qershor 1932 edhe pse sëmundja i ka krijuar probleme të shumta. Punën si mësues i gjuhës shqipe e fillon në një shkollë në fshatin Vrakë me popullësi malazeze, afër Shkodrës më 23 prill 1933.

Në të njëjtën kohë fillon të shkruajë poezi dhe prozë, për jetën e një vendi që ka mbetur rajoni më i prapambetur në Evropë. Prozën e parë e ka shkruar në maj 1934. Ishte *Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun*, që u botua në revistën “Illyria”, nën akronimin e ri- Migjeni. Në vitin 1935, Migjeni sëmuret rëndë nga tuberkulozi. Proza e Migjenit përmban rreth njëzet e katër skica, të cilat janë botuar nëpër revista nga viti 1934 deri në viti 1938. Disa vjersha, si *Të birtë e shekullit të ri*, *Zgjimi*, *Kanga e rinis* dhe *Kanga e të burgosunit* janë një luftë e hapur revolucionare. Pastaj shkroi poezinë me 105 vargje *Poema e mjerimit*. Migjeni vdiq më 26 gusht 1938, në Torre Pelice (Torre Pellice). Vdekja e tij në moshë të re është një humbje tragjike për letërsinë bashkëkohore shqiptare.

Millesh Gjergj Nikolla ka qenë poet dhe prozator i shquar shqiptar i viteve 30 -ta. Ai është një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm dhe më të lexuar të letërsisë shqipe. Ndikimi mbi letërsinë shqipe të kohës ishte i madh për arsye se shkrimet e tij ishin novatore si nga brendia poashtu edhe nga forma. Migjeni gjatë jetës së tij kalon prej romantizmit në realizëm. Varfërinë

e viteve kur jetoi e ka trajtuar në shumë vepra nga të cilat do t'i veçojmë: "Bukën tonë të përditshme falna sot", "Bukuria që vret", "Mollë e ndalueme", "A don qymyr zotni?", etj.

Pas Luftës së Dytë Botërore u përhap krijimtaria e tij, pasi regjimi komunist botoi veprat e plota, të cilat në vitet 1930 kanë qenë pjesërisht të botuara.

Një krijues me talent të jashtëzakonshëm, i ri në moshë, i shtohet letërsisë shqipe të asaj kohe, një "rebel", një protestues, një zë ndryshe nga të tjerët. Migjeni i rrënon tabutë dhe këtë e dëshmon fakti se ai që në moshë fare të re nga seminari faktikisht del si një antiseminarist. Shqipëria ka qenë nën udhëheqës liberal në kohën kur shfaqet Migjeni si krijues, dhe po ky fakt na dëshmon që në Shqipërinë e asaj kohe janë shfaqur shkrimtarë, të cilët pikëpamjet e tyre i tregojnë hapur. Migjeni në veprën e tij e pasqyron jetën reale të shqiptarëve në Shqipërinë e viteve të 30-ta, por këto fatkeqësi që po i jetojnë nuk janë pasojë e ndonjë tirani, por probleme të trashëguara nga brezi në brez.

Është e drejtë nëse thuhet se krijimtaria letrare e Migjenit është revoltë ndaj sëmundjes e cila e kaploi që në moshë të re. Jeta e tij është e shkurtër por shumë domethënëse siç është edhe vepra e tij me karakter përjashtues por jo konfortuese.

## **I. 2. Momente historike dhe shoqërore në kohën e Migjenit**

Kultura shqiptare në vitet tridhjeta hyn në një fazë tjetër të zhvillimit të saj. Një shkallë më e lartë e arsimit të intelektualëve dhe idetë që kanë ardhur nga jashtëvendi kanë ndikuar në zhvillimin kulturor më të shpejtë. Është krijuar vetëdija për krijimin dhe vlerën e tij. Me paraqitjen e revistave letrare me koncepte të caktuara është krijuar edhe atmosfera e dialogut letrar. Në këtë kohë janë kultivuar kriteret letrare njësoj si me veprat e shfaqura, ashtu dhe në shkrimet kritike. Letërsia dhe kultura shqiptare kanë lulëzuar si kurrë më parë. Migjeni, duke qenë më largpamës nga bashkëkohasit e tij e tejkalon tradicionin dhe i jep letërsisë shqiptare dhe kulturës shqiptare një vend më të lart në Evropën bashkëkohore.

Në letërsinë shqipe Migjeni sjellë shumë risi, për këtë shkak njihet edhe si poet novator. Ai në mënyrë të hapur shpreh impulse intime të cilat nuk kanë qenë të para në letërsinë tonë. Ai përpunon edhe shumë tematika të tjera si homoseksualizmi, edhe pse nuk ka arriturë të punojë shumë në këtë sferë nga jetëshkurtësia e tij. Është munduar me gjithë shpirt të thyejë shumë tema tabu. Te veprat e Migjenit shohim seksualitet të shtypur, shohim shumë figura të grave të përshkruara si nga ana fizike ashtu edhe nga ana shpirtërore. Migjeni tregon një mëshirë të jashtëzakonshme ndaj figurës së gruas.

Poezitë e Migjenit edhe pse nuk ishin të botuara në libër, kishin shumë sukses të madh. Për krijimet e tij dhe zhvillimin e tij letrar nuk mund të bëjmë një analizë shumë të gjërë dhe kritikë të plotë ngase jeta e tij ishte shumë e shkurtër dhe për këtë edhe krijimtaria e tij edhe pse për kohë e shkurtër ishte shumë domethënëse dhe veprat e tij akoma lexohen.

Mbi prozën dhe poezin e tij është shkruar në shumë revista, artikuj, monografi. Në numrin 5 të revistës “Nëndori” viti 1954 për Migjenin shkruhej: *“Mendoj se shkrimtarëve tanë u bie marra që Migjenin, duke e gjykuar drejt, ta vënë në vendin që janë interesuar për poetin, kanë çfaqur disa dyshime të padokumentuara, sikur gjoja Migjeni nuk e ka patur të qartë prespektivën e revolucionit, që do të bëhej në vendin tonë”*. Ky konkluzion tingëllon deri diku si një fymje e padrejtë që i bëhet Migjenit nga kritika jonë<sup>3</sup>.

Shumë emra të shquar kanë dhënë kritika për veprat e Migjenit. Do t'i veçonimdisa si më specifikë duke filluar nga Ismail Kadare i cili për Migjenin ka thënë: *“Ai siç e shpall vet ka qejf të zhgërryhet në baltat e kohës, të përshkojë tejmbanë ferrin e saj. Është kurthi më i madh për një shkrimtar kur ekrani tepër i afërt i ngjarjeve, pasioni dhe anësia mund t'ia sigurojë militanizmin, por t'ia zbehin vizionin e madh artistik. Madhështia e Migjenit qëndron pikërisht në atë që, edhe duke qenë në terr e në baltë nuk e humbet”*<sup>4</sup>.

Rexhep Qosja për Migjenin ka komentuar: *“Sa i përket formës së vargut, Migjeni asht origjinal në letërsinë tonë. E vërteta që e transporton ai artistikisht mund të ketë shprehjen ma të mirë dhe ma adekuate vetëm ndërmjet vargut të lirë. Por, ajo që fjalës poetike të Migjenit i jep gjallni gjithnjë dhe e ban të fosforenshojë me kualitetet e saj asht thellësia dhe sinqeriteti i*

---

<sup>3</sup> Migjeni, *Vepra 4*, f. 248.

<sup>4</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, vep. e cit., f.24

*ndjenjës me të cilën janë mbrojtë ato vargje, asht flaka vullkanike me të cilën asht shkri subjekti i poetit, tue krijue botën e tij artistike*"<sup>5</sup>.

Format e reja të shprehjes nuk janë faktori kryesor i cili do ta përcaktojë Migjenin, ajo çka e përcakton është përmbajtja e re ideore dhe tematika shoqërore. Migjeni hyn në letërsinë shqipe duke thyer të vjetrën, duke e çuar më tej letërsinë si në brendi dhe në formë. Disa nga arsytet që e kanë shtyrë Migjenin për të sjellë risi në letërsinë shqipe kanë qenë rethanat socio-ekonomike si pasuria e agallarëve, rendi i egër policor, klerikët fetar, shtypja e fuqisë punëtore. etj. Motiv i tij që përmes veprave të tij ta ndërronte këtë mentalitet primitiv kanë qenë këto të lartpërmendurat. Migjeni zgjedh pendën si armë ndaj padrejtësive, dhe nga pamundësia e tij për të bërë diçka më shumë që të ngrijë vetëdijen dhe ndërgjegjen te shtresa e lartë.

Shkrimtari pasqyron sfera të reja të jetës, njerëz të rinj, të cilët deri atëherë nuk kishin gjetur pasqyrim të drejtë dhe të thellë. Të vërtetën ashtu siç ishte, realitetin e dhimbshëm dhe të hidhur e thotë Migjeni në veprën e tij që e la trashëgimi letërsisë shqipe, duke vënë në pah dhe duke ju dhënë vëmendje shtresave të varfëra të popullsisë, ngjarjet e dhimbshme, për jetën e zymtë të këtyre njerëzve.

Veprat e tij, edhe pse të pakta, kanë shumë peshë dhe një cilësi të lartë artistike. Fuqia e tij e fjalës, saktësia e përshkrimit e çuan përpara realizmin kritik në letërsinë tonë. Migjeni edhe pse nuk e zhvilloi shumë, ia vlen të përmendet që ai preku edhe temën e homoseksualizmit.

Proza e Migjenit filloi me skica të cilat grupohen në dy lloje: skica, ku kryesisht paraqiten problemet filozofike, shoqërore, kulturore dhe artistike, dhe skica ku pasqyrohet jeta reale, skena dhe portrete njerëzish. Novelat e qytetit të veriut zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Migjenit dhe në mbarë prozën shqiptare të kohës. Prozat e shkurtëra në vitet '20-'30 janë quajtur novela dhe kanë pasur për qëllim të zbulojnë te personazhet tiparet e tyre thelbësore dhe të formuara nën veprimin e mjedisit shoqëror.

---

<sup>5</sup> Po aty, f.25.



Vepra letrare e Migjenit është vendosur në një nga majat më të larta të letërsisë sonë kombëtare. Migjeni vdiq i ri, në moshën 27 vjecare dhe la pas një trashëgimi letrare të paktë në sasi por me shumë vlerë të madhe.

Migjeni, si poet i nderuar këto dekadat e fundit, duket sikur e ka zënë vendin e plotë në letërsinë tonë kombëtare. Por nëse analizojmë pak më thellë duhet te rishikohet edhe njëherë vlerësimi i veprës së tij letrare.

Vlerësimet e krijimtarisë letrare të Migjenit nuk kanë shpëtuar nga ndikimi i skemave e dogmave. Janë bërë shumë përpjekje për ta paraqitur Migjenin si përfaqësues autentik të realizmit socialist në letërsinë shqipe, edhe pse ka shumë fakte, që janë lënë anash e që tregojnë se një nga shqetësimet më të mëdha të Migjenit, ka qenë të mos rrëshqite në “lojrat” politike e ideologjike të kohës, të mos bëhet pre e tyre. Nuk ka qenë e lehtë për Migjenin që ta ruajë pozicionin e tij të ndershëm. Me krijimtarinë e tij poetike ai ka kërkuar rrugë për shpëtim nga vështirësitë rethanore politike.

Grupet komuniste e ftonin Migjenin t’u bashkangjitet drejt ideologjisë së Bashkimit Sovjetik, si një rrugë e vetme drejt përparimit, por kur komunistët i prishën marrëdhëniet me sovjetikët e harruan edhe këtë ideologji. Migjeni ishte i zhgënjyer dhe i dëshpëruar nga iluzionet racionaliste, këtu kishin ndikuar edhe përvojat që sidoqoftë udhëheqës janë forcat iracionale.

Pushteti i atëhershëm mundoheshte ta vinte Migjenin në lojëra politike, duke kërkuar nga ai që ti lavdëronte, por Migjeni nuk ra pre e këtyre kërkesave. Ai haptazi i kritikonte dhe i dënonte veprimet e tyre dhe shkeljen e tyre ndaj popullit shqiptar. Mënyra e tij ishte proza e poezia. Edhe pse mund të duket e paktë dhe e dobët lufta e tij, ai arriti vetëdijësim dhe ndërgjegjsim te populli dhe te shtresat e larta.

Veprat e tij na zbulojnë momente dhe ngjarje kyqe nga historia e popullit shqiptar, poashtu të njejtën e bën edhe për letërsinë e gjuhës shqipe. Migjeni i dha letërsisë peshë shoqërore e estetike, që patën gjatë Rilindjes Kombëtare shkrimtarët si: Naimi, Fishta dhe Çajupi e më vonë edhe F. Nolit. Migjeni e ripërtriu mesazhin e këtyre poetëve, për çlirim shoqëror dhe kombëtar.

Migjeni dhe veprat e tij u bënë më të njohur dhe më të vlefshme ndërmjet shkrimtarëve të viteve të 30. Ai zhvilloi një frymë të re në Shqipëri, një frymë kritikuese, gjë e cila ekzistonte në letërsinë botërore. Ai na njoftoi me realizmin social të Shqipërisë dhe të popullit shqipëtar. Poeti zbuloi mjerimin, realitetin e shoqërisë shqiptare të viteve 30. Mundohet me aq sa ka forcë ta ndëshkojë dhe ta dënojë mjerimin, situatën në të cilën ndodhet ai dhe populli i tij. Ngjarjet konkrete të historisë nuk e tërhiqnin atë, por përvoja e njerëzve nga ato ngjarje. Ai thellë, në shpirtin e tij, i shikonte gjërat me një sy ndryshe nga të tjerët. Ai i përjetonte tragjeditë, fatkeqësitë e tjerëve edhe nëse nuk i ndodhnin atij. Ai mbante frikë në vete që ardhmëria e kombit nuk do të ndryshonte nga gjendja e atëhershme dhe këtë e shpreh me vargjet e tij.

Migjeni ishte ndryshe nga poetët e tjerë. Ai e solli realizmin te populli ynë. Nuk mjaftoheshte me iluzione iluministe e racionaliste. Ai kërkonte rrënjën e proceseve, poashtu edhe pasojën. Përvoja e mësoi që gjërat jo gjithmonë shkojnë sipas dëshirave dhe jo gjithmonë komandon arsyeja po ka goditje edhe nga forcat irracionale. Për të historia është një mësues që zhvillon dhe paraqet ndeshjen mes të mirës dhe të keqes, mes krijimit dhe shkatërrimit. Ai përshkruan se si te një njeri kemi edhe të mirën por e kemi edhe të keqen, e kemi forcen krijuese por edhe shkatërruese. Vepron “Njëriu – Sokrat”, por edhe “Njëriu-Derr”. Me këto veprime njeriu mund të krijojë por edhe të shkatërrojë. Rruga e jetës nuk shkon si një vijë e drejtë, kemi ngritje dhe rrëzime, kemi veprime dhe pasoja, ndonjëherë pasojat janë të papritura dhe të padëshiruara. Gjërat mund të ndodhin edhe pa parashikime.

Ai në të gjitha veprat e tij u përpoq të shikojë dhe të paraqesë gjënë më kryesore-ekzistenciale. Në krijimtarinë e tij zotërojnë temat e lumturisë dhe fatkeqësisë, fati i njeriut në përgjithësi. Ai as nuk i idealizonte njerëzit si të përsosur po as nuk i nënshtronte, ai mundoheshte t’i shikonte gjërat si janë në të vërtetë, duke i pasur parasysh edhe rethanat shoqërore që i krijojnë veprimet e njerëzve. Brenda lindjes dhe vdekjes, sipas poetit, kishte gjëra të bukura, ngjarje të mira por edhe fatkeqësi të tmerrshme, trishtuese dhe të hidhura.

Jeta, sipas tij falte gëzime po edhe dinte të ishte edhe më e ashpër, dinake. Ishte e vështirë sa që edhe para se të lindte fëmija ishte i mallkuar nga e ëma e tij. Jeta ishte e mallkuar sepse sillte vetëm vuajtje dhe dhembje. Lot e dhembje ishte për të varfërit, ndersa të pasurit qeshnin, shkelnin dhe shfrytëzonin fatkeqësinë e tyre.

Migjeni ka qenë dhe do të mbetet aktual. Edhe pse kohërat ndryshuan, edhe pse mjerimi nuk ndihet më në përmasat e mëdha, veprat e tij gjithmonë do të na japin emocionet e papërshekruara. Do ta ndiejmë dhimbjen e popullit sa herë do të lexojmë veprat e tij. Askush nuk mund të jetë indiferent ndaj poezisë dhe prozës së tij. Intelekti i tij ka frymëzuar dhe do të na frymëzojë gjithmonë. Rrugat e së vërtetës edhe pse e hidhur gjithmonë do të na japë ndjenjën e të qenit njeri. Nxitje e vërtetë ndaj demokracisë është vepra e tij.

### **I. 3. Gruaja shqiptare në kontekstin e prozës së Migjenit**

Migjeni ndonëse jetoi shumë pak dhe gjatë gjithë jetës pati një shëndet të lig, vepra e tij ka një domethënie dhe rëndësi shumë të madhe për popullin tonë. Migjeni nga kritika deri vonë është lënë në heshtje. Ai është quajtur poet revolucionar por vetëm nga ata që nuk e kuptojnë.

Veprat e Migjenit, edhe pse në numër të vogël, lanë një gjurmë shumë të madhe në letësinë tonë. Ai shkruajti për një kohë shumë të shkurtër, por me ato shkrime të pakta, ai tha dhe tregoi shumë. Poezia e tij e paraqet dhimbjen e asaj kohe, por edhe na përfaqëson karakterin e një poeti me vizion të gjërë, poet i cili ndikoi që letërsia shqipe të ngritet në nivel më të lartë artistik. Ai në mënyrë të përsosur e shpjegon barrën e rëndë e cila e godet femrën e cila gjithmonë gjendet në mes, kur përplasen traditat dhe civilizimi dhe uria me ngopjen. Realiteti shoqëror është shkak për rrënimin e moralit të gruas, e cila do të lindë vetëm për të mbushur rrugët.

Në kohën e Migjenit, në shoqërinë të asaj kohe, gjëja e parë që shkelet është dinjiteti i femrës, ajo bëhet simbol i dhimbjes, por poeti nuk e kritikon sjelljen dhe veprimet e femrës, por do të ngjallë ndërgjegjen të pasanikët, pushtetarët të cilët i sheh si fajtor për gjendjen e gruas. Femra shqiptare gjithmonë ka qenë viktimë e patriarkalizmit. Në shumë proza të Migjenit, gruaja është në qendër të vëmendjes, ai me plot dashuri krijon personazhet e grave të cilat mund të bëjnë gjëra më të turpshme, të jenë shumë naive, por nuk janë fajtorë. Fajin e ka shoqëria. Migjeni mundohet me shpirt që t'i thyje konceptet e vjetëruara, edhe pse në atë kohë nuk ka ndodhur ndryshimi, ditët e mira për gratë shqiptare kanë ardhur, dhe do të vijin ditë edhe më të mira.

Te veprat e Migjenit, është e pamundur të mos shihet pozita e gruas në atë kohë. Ajo nuk ka qenë e lumtur, as e respektuar, por vetëmse e përbuzur, pa dinjitet dhe e nënshtruar ndaj epsheve të zotnive. Realiteti i hidhur ka qenë ky. Personazhi i gruas te veprat e Migjenit, na tregon qartë që gruaja ka qenë e përlur, ka ecur rrugën me therra gjatë jetës së saj, dhe ky ka qenë një realitet që është përjetuar e jo një ëndërr e keqe që është ëndërruar.

Te vepra “Gruaja”, Migjeni e dënon ashpër mentalitetin e prapambetur dhe mundohet të vetëdijësojë popullin për lirin e tij nga morali i rrejshëm. Ai flet me dashuri dhe dhembshuri për gruan, për këtë shkak edhe përveç elementet të realizmit, në formimin stilistik, kemi edhe elemente të rrymave të tjera letrare.

Figura e gruas te veprat e Migjenit e shpalos moralin e rrejshëm, i shpalos tradicionet e prapambetura të Kanunit, sjelljen dhe ngritjen e gjinisë mashkullore si diçka që është më e vlefshme nga femra. Shoqëria e asaj kohe aspak nuk ka qenë vetëkritikuese dhe e ka pasur bazë patriarkalizmin, ku gjithmonë burri ka qenë më shumë, më mirë, më me vlerë nga gruaja.

Migjeni me veprat e tij u përpoq të ngrejë temën, problematikën e gruas shqiptare te asaj kohe, të viteve 30-ta, shoqërinë dhe botëkuptimin e shoqërisë. Edhe pse nuk mund të bënte diçka më shumë, ai me anë të shkrimeve mendohej t`ua tregojë vendin e rëndësishëm të cilin duhej ta kishte gruaja në shoqërinë e kalbur. Jeta e saj e mbushur me fatkeqësi, konflikte, zhgënjime dhe dëshpërime, ishte rezultat i pushtetit dhe mentalitetit të prishur në thelb, mentalitet të trashëguar.

## **KAPITULLI II**

### **II.GRUAJA SHQIPTARE DHE ROLI I SAJ NË JETËN SHOQËRORE**

Gruaja shqiptare ka treguar gjithmonë një mençuri të madhe e sidomos edhe nëse i marrim parasysh sfidat me të cilat është ballafaquar ndër vite, poashtu edhe rrethanat historike në të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë shqiptare. Ajo ka dhënë kontribut të madh dhe sakrificë për familjen, kombin dhe si pasojë e okupimeve të gjata, e kuptojmë se gruaja shqiptare është sakrifikuar por edhe ka luftuar për të drejtat jo vetëm të saj por edhe e të gjithë kombit. Sakrificat e grave të cilat hynë në histori, u bënë model, udhëheqës dhe tregues të gruas luftëtare për të drejtat e vendit e popullit dhe u bënë frymëzim për artistët më të njohur të kombit; Mbretëresha Teutë, Shotë Galica, Dora D'Istria, dhe të tjera, me rëndësi shumë të madhe dhe me vlera aq të mëdha që e bëjnë shumë të vështirë të veçohen.

Pastaj kohërat ndryshuan. Duke filluar prej viteve të gjashtëdhjeta e këtej nisi ngritja graduale e gruas në shoqëri. Gruaja shqiptare gjatë këtyre viteve filloi të kërkojë të drejtat e saj dhe të barazohet ngadalë me gjininë mashkullore në të gjitha mjediset, në të gjitha fushat e veprimit politik, shoqëror, ekonomik e të tjera. Por si pasojë e paragjytimeve, egoizmit dhe prepotencës mashkullore, gratë shqiptare të drejtat e tyre i kanë pjesërisht të realizuara. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, arsimim të vazhdueshëm të femrat poashtu dhe ngritja e vetëdijes të popullit ynë, kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në vazhdimësi për të arritur femra qëllimet e saj, të jetë e vlerësuar dhe të fitojë barazinë të cilën gjatë e ka kërkuar.

## II. 1. Gruaja shqiptare e shekullit XIX

Poetë të shumtë kanë trajtuar femrën nga aspekte të ndryshme në letërsinë moderne shqipe. Haki Stërmilli me romanin e tij “ Sikur t’ isha djalë”, Ndre Mjeda me poemën e tij “Andrra e jetës” si dhe Migjeni me poezinë e tij “Baladë qytetase”, janë ndër poetët më të shquar të cilët e kanë trajtuar me shumë temën e të qenit femër në atë kohë. Migjeni ka trajtuar problematikën e mjerimit, ku bën pjesë edhe femra shqiptare.

Në “Baladë qytetase” Migjeni me anë të gjendjes fizike paraqet gjendjen emocionale të femrës. Ai, figurën e femrës e trajton nga aspekti psikologjik dhe si ndihet femra, e cila jeton në skamje. Çfarë ndikimi ka skamja në karakterin e veprimeve të femrës. Poeti e përshkruan qenien femër si hije. Ky simbol ka një kuptim të madh të cilin e përshkruan Migjeni. Ai e kupton dhe e shpjegon termin hije të cilin ja ka veshur femrës, si simbol i: nënshtrimit, përbuzjes, shkeljes. Ai tregon që femra shkelet, përbuzet nga të tjerët, është lodër në duart e gjakpirësve. Ai e paraqet personazhin e femrës si një qenie e dëshpruar, e zhgënjyer dhe e thyer në shpirt. Por ai nga ana tjetër e mbron atë, e mbron me gjithë qenien e tij, duke shkruar për të dhe duke arsyetuar atë. Për Migjenin femra nuk ka faj që është lypëse, prostitute ose engjull.

Këtë faj ai ia vesh mentalitetit të kalbur të shoqërisë. Shoqëri e prapambetur për të. Shoqëri e shkelur nga pushtuesit. Por jo gjithë fajin e kanë pushtuesit, se nga pikëpamja e tij objektive dhe realiste, shoqëria vetë mund të bëjë ndryshimin, mund të bëjë dallimin. Te “Baladë qytetase ai trajton jetën e femrës, rrinë dhe pleqërinë.

Dikur ajo ishte e re e bukur natyrisht që pëlqejë nga masa e gjerë. Me anë të kësaj poeti na rrëfen se bukuria vyshket, rinia është vetëm një fazë e jetës, e cila fluturon shpejt dhe se gabimet e rinisë dhe vetëpëlqimi janë dy nga shkaqet kryesore që pleqëria të shoqërohet nga vetmia. Por pavarësisht këtyre gjërave të lartcekura, Migjeni jo që nuk e fajson, ai në një mënyrë

duke kritikuar e dënon shoqërinë e asaj kohe që ishte fajtores për fatin e kësaj femre. Me veprat e tij, Migjeni na tregon që femra aspak nuk jeton, por gjëja më kryesore është të mbijetojë. Prandaj përshkrimi i femrës në poezinë “Baladë qytetse” është shembull i luftës për mbijetesë. Pasqyrë e jetesës së saj janë sytë, të cilat janë gjithmonë të gatshme t’ia plasin vajit. Në poezinë “Baladë qytetse” ai i trajton dy fazat kryesore, dhe më të rënda për njeriun, rininë dhe pleqërinë. Sipas gjithë kësaj mund të vijmë në përfundim se Migjeni përveç trajtimit të fizikut së femrës, ai thellësisht e trajton edhe gjendjen psikologjike, gjendjen shpirtërore të saj.

## **II. 2. Perceptimet shoqërore të gruas shqiptare nëpër fazat e zhvillimit letrar**

Me fundin e shekullit të arsyës dhe fillimin e Romantizmit përkon fillimi i shekullit të XIX në Evropë. Kushtet teknologjike bëjnë të mundur edhe përhapjen e dukurisë së udhëtimit dhe kontaktit me kulturat e reja. Edward Gibboni, autor i librit historik me 10 vëllime “Rënia dhe tkurrja e Përandorisë Romake” (1776) përshkruan një nga vendet, që sipas tij ishte një vend që mund të shihet nga brigjet e Italisë, por që njihet më pak sesa brendësitë e Amerikës, ishte Shqipëria. Në vitin 1809, Lord Byron dhe Hobhouse vizitojnë Ali Pashë Tepelenën në vendlindjen e tij në Tepelenë e bëjnë rizbulimin e saj në Evropë.

G. G. Byron (1788-1824) Udhëtari dhe poeti i njohur romantik përshtypjet dhe eksperiencat e tij nga udhëtimi i tij, ku përfshihej dhe Shqipëria e asaj kohe i përshkroi në veprën poetike “The Pilgrimage of Child Harold” (1812), vepër e cila e bëri atë të famshëm në letërsinë botërore. Me përshkrimet e jetës shqiptare, poeti i madh anglez përshkruan dhe gratë shqiptare. Gruaja shqiptare ka qene e shquar për bukurinë e saj, modestinë dhe aftësinë për të qenë e zonja që të sakrifikojë edhe veten për mirëqenien e të tjerëve. Andaj, edhe të huajt e kanë parë të arsyeshme të shkruajnë dhe t’i jetësojnë femrat shqiptare në veprat e tyre.

Kjo është një nga përshkrimet e para të gruas shqiptare që paraqitet në kulturën europiane. Gruaja shqiptare në atë kohë ka jetuar në një shoqëri patriakale siç ka qenë shoqëria e Përandorisë Osmane. Mes gjithë epiteteve lavdërues për bukurinë e tyre, gjë për të cilën bien dakord. Gjithë udhëtarët e huaj të shekullit të XIX, e lavdërojnë gruan shqiptare dhe bukurinë e saj, por çfarë

bie në sy është përshkrimi i tij në të cilin ai shpjegon që gruaja shqiptare është në kafaz. Në pak rreshta Bajroni rrëfen statusin social të gruas shqiptare e cila del pothuajse gjithmonë e mbuluar. Mbulesa e saj gruan shqiptare e ben edhe me joshëse pasi çdo gjë që është e fshehur gjithmonë është më tepër e dëshiruar. Në të njëjtën kohë ai gdhend dhe tiparin e besnikërisë dhe përkushtimin ndaj fëmijëve dhe familjes.

Francois Pouqueville konsulli francez në Janinë (1806-1814) në të njëjtën kohë i përcjell përshtypjet tij për femrat shqiptare. Francois Pouqueville studimet i ka filluar në teologji, por Revolucioni Francez e bën që të ndërrojë studimet dhe të vazhdojë studimet në mjekësi. Ai ka qenë pjesë e ekspeditës shkencore franceze në Egjipt dhe çka i ka tërhequr vëmendjen kanë qenë profesionet e tjera si gjeologji, etnografi, etnopsikologji, histori të disa popujve të Ballkanit. Pouqueville nëntë vjet ka qëndruar pranë Ali Pashë Tepelenës në Janinë (mars 1806-shkurt 1815), si konsull i përgjithshëm frëng, kohë në të cilën e ka shkruar edhe veprën e tij të madhe “Udhëtime në More, Shqipëri dhe Përandorinë Otomane”. Ai ka lënë përshkrime rreth femrës shqiptare, të cilat i shikon si amazona moderne. Pouqueville i gdhend me penën e vet si hyjnesha të bukurisë dhe gjuetisë.

*“Armëmbajtëse tek Skipëtarët e Drinit, vështrimi i tyre krenar, ecja kryelartë tregojnë se ato janë bashkëshortet dhe nënat e atyre burrave kalitur në sfilitje, mësuar me rreziqet, që po aq sa nuk njohin kënaqësitë e jetës, po aq shpërfillin edhe vetë vdekjen si të mos ishte gjë. Kur shtegtojnë, me brezin gjithë pishqolla, shoqëruar nga qen të tmerrshëm që i nënshtrohen zërit të tyre, i merr për Dianë a për shoqet e veta...I sheh në luftëra kur vatra atërore kërcënohet, amazona të reja tek zënë vend në radhët e luftëtarëve dhe tek i cysin këta për të bërë kërdrinë. Të krishtera apo muhamedane, asnjë prej tyre nuk mban përçen e sajuar nga xhelozia orientale; të bukura, gjithë ndrojë e dëlirësi, veç i kushtohen një familje të shumtë...”<sup>6</sup>.*

Të dy autorët nënvizojnë që një ndër tiparet që e karakterizojnë gruan shqiptare është besnikëria ndaj familjes dhe fisit të vet. Një ngjarje tragjike që ka frymëzuar dhe piktorët e mëvonshëm europianë pasi kanë lexuar librin e Pouqueville, “Udhëtime në More, Shqipëri dhe Përandorinë Otomane” ka qenë ngjarja e vitit 1803 gjatë rrethimit të Sulit, domethënë një nga

---

<sup>6</sup>Fotaq Andrea, *Pena të arta franceze për shqiptarët*, (1332-2007). GentPrint, Tiranë:2009.



historitë e Sulit. Malësorët trima të Sulit në datën 25 dhjetor 1803, kanë nënshkruar aktin e kapitullimit para Veli pashës, i cili ka pranuar kushtin që ata të largoheshin jashtë kufijve të pashallëkut.

Ndërmjet Ali Pashës dhe suliotëve fillon dhe një nga keqkuptimet më të mëdha, pasi Ali Pasha dëshironte që ata të mbeten brenda kufinjve të pashallëkut, sepse nëse ata do të largoheshin, do t'i kishte kundërshtarë të përjetshëm. Suliotët nuk kanë pranuar të kthehen dhe kanë filluar luftimet me repartet e Vezirit edhe pse Ali Pasha ju ka premtuar se do t'u krijonte kushte jetese dhe pune. Në këto luftime është treguar edhe heroizmi i grave të Sulit, të cilat e kanë sakrifikuar veten e tyre së bashku me gjithë fëmijë duke u hedhur në rrëpirën e shkëmbit të Zalongut. Ibrahim Mansur Efendiut, autorit të “Kujtimeve nga oborri i Ali Pashës” (1828) i është përshkruar një dëshmi konkrete e valles së Zalongut, nga një oficer i quajtur Sulejman Aga i ushtrisë së Ali Pashë Tepelenës. Ai ka qenë dëshmitar në ngjarjen e dhimbshme që ka ndodhur në shkëmbinjtë e Zalongut, në Sul të Çamërisë. Gratë të mbajtura për dore kanë filluar një valle, sipas kësaj dëshmie, e cila ishte udhëhequr nga një heroizëm, me një frikë nga vdekja dhe duke përforcuar ritmin. Më në fund, gratë të lodhura kanë lëshuar një klithmë rrëqethëse që nga shkëmbi prek së cilit janë hedhur bashkë me fëmijët e tyre.

*“Gratë e Sulit ishin nga të parat gra shqiptare që u bënë subjekt i tablove të romantizmit europian për fatin tragjik të tyre. Në vitin 1820 piktori Claude Pinet, realizoi tablonë “Vallja e Zalongut”. Po kështu piktori romantik Ary Scheffer pikturoi tablonë “Femrat Suliote” (1828). Akti tragjik i femrave suliote është regjistruar dhe në memorien kolektive përmes folklorit”<sup>7</sup>.*

Pasqyrimi i femrave shqiptare në artin botëror fillon që nga ky moment. Nga Theodore Labarre, kompozitor i njohur francez, që ka kompozuar opera, balete dhe romanca, si dhe është dekoruar Kalorës i Legjionit të Nderit të Francës më 1862 është muzika e romancës “La jeune albanaise” apo “Vasha shqiptare”, e shkruar më 1833. Teksti i këngës është nga shkrimtari Ambroise Bétourné, nga Kaeni i Normandisë. Romancat “Festa e Madonës”, “Kujtime nga vendlindja”, “Vasha syzezë”, “Zezakja e shkretë” janë shkruar nga ky shkrimtar francez dhe janë nga më populloret, të cilat janë përcjellë gojë më gojë për vite të tëra, janë kënduar nëpër festa, ballo e gëzime kolektive etj. Kjo romancë jep imazhin romantik të kulturës europiane të ushqyer

---

<sup>7</sup><http://www.gazetadita.al/fillesat-e-pasqyrim-it-te-gruas-shqiptare-ne-kulturen-europiane-ne-shekullin-e-xix/> (10.04.2020)

nga kultura ballkanike ndersa përshkrimi i vajzave shqiptare dëshmon për kontaktin e autorit me kulturën shqiptare.

Tabloja “Vajzë e re shqiptare e veshur me kostum popullor duke mbledhur rrush” nga Johann Frankenger (1846) mbetet si një simbol i bukurisë fizike të vajzës shqiptare. Johann Frankenger (1807-1874) ka qenë një piktor vijenez që ka realizuar shumë tablo, portrete të aristokracisë vijeneze dhe gjermane dhe të zyrtarëve të lartë nga Lindja e Afërt. Vajza shqiptare ka të ngjarë që të jetë e bija e një prej ushtarakëve të lartë që shërbenin në ushtrinë austriake. Johann Frankenger nuk e ka vizituar kurrë Shqipërinë dhe tabloja e tij duket se është realizuar mbi përvojat emocionale të piktorit. Te tabloja është vizatuar dritarja e një pallati të hijshëm, ku shquan dhe elementi gjeorgjik nëpërmjet bistakëve të rrushit që mbledh, por mbi të gjitha një përshkrim i veshjes tradicionale shqiptare. Jeleku i femrave shqiptare pastaj paraqitet pothuajse në të gjitha tablotë ku paraqiten femra shqiptare. Në koleksionin Durham në Bankfield Museum në Halifax ndodhet një jelek i tillë si pjesë e koleksionit që e ka dhuruar udhëtarja britanike Edith Durham. Jeleku i qëndisur me ar dhe mëngë ka qenë një veshje e aristokracisë së lartë shqiptare dhe dëshmon për një nivel mirëqenie të shtresave shoqërore që e vishnin. Në të bie në sy sasia e madhe e arit e përdorur për të realizuar ornamentet e ndryshme.

“Serafina Topia” (1839) e ribotuar më e plotë me titull “Një pasqyrë e jetës njërzore” (1897) nga Jeronim De Rada është poema e cila paraqet një nga trajtimet më të plota të femrës shqiptare në letërsi. De Rada i përket komunitetit arbëresh, ajo meriton një vëmendje të veçantë pasi është krijuar në Itali dhe për rrjedhojë është një këndvështrim europian mbi femrën shqiptare. Kjo paraqitje është e rëndësishme pasi është e përshtatur në ambientin europian të mbretërisë së Napolit. Serafina Topia si heroina kryesore e veprës, sakrifikohet për familjen e atdheun, gjë që është tipike si temë e romantizmit arbëresh, dhe pastaj u shfaq edhe në letërsinë shqipe. Gruaja shqiptare dhe ideali i njeriut i zhvilluar në mënyrë të gjithanshme është i mishëruar me Serafina Topinë.

Personazhi i krijuar nga De Rada, Serafina Topia përfytyron tiparet fizike dhe kulturore të gruas arbëreshe. Ndërsa një nga katër gratë më të rëndësishme të Europës në shekullin e XIX, Elena Gjika alias Dora D’Istria është simbol i gjenialitetit intelektual mes grave shqiptare . Dora D’istria ka lindur në Bukuresht më 22 janar 1828 dhe ka njohur shkëlqyeshëm kulturën franceze, italiane dhe greke. Dora D’Istria vet e pohon që origjina e familjes së saj është shqiptare. Ajo

shkruan në librin e vet “Shqiptarët në Rumani. Historia e princërve Gjikaj në shekujt XVII, XVIII, XIX” se Del Chiaro, shkrimtar, e ka gabim me pretendimet se Gjikajt janë grekë, por në të kundërt ata jashtë çdo dyshimi janë shqiptarë. Mësimet e para i ka filluar në Konstancë dhe pastaj në Bukuresht, kurse studimet e larta i filloi në Vjenë e pastaj i ka vazhduar në Dresden e në Berlin. Elena u kthye në Bukuresht në shkurt të vitit 1849.

Ajo njihnte mirë frëngjishten, italishten, gjermanishten anglishten, rusishten, greqishten, shqipen e sidomos rumanishten, me të cilat zgjëroi diturinë dhe gjithashtu ka dhënë mendime të vlefshme në shumë studime dhe vepra letrare. Ajo debutoi për herë të parë në 1855 në frëngjisht *La vie monastique dans l’Église orientale*. Veprat e saj më të shquara janë: “La nationalite Albanaise d’apres les Chants populaires-Les Albanais des deux Cotes de l’Adriatique” (1866) “Kombësia shqiptare, sipas këngëve popullore, Shqiptarët e dy brigjeve të Adriatikut”, “Les ecrivains Albanais de d’Italia meridionalë” (1867) “Shkrimtarët shqiptarë të Italisë së Jugut”, “Excuisses albanaises” (1869) “Vizatime shqiptare”, “Gli Albanesi in Romania” (1873) “Shqiptarët në Rumani” etj. Ajo ka bashkëpunuar me organe të rëndësishme të kohës si: “Revue de Deux-Mondes”, “Independence hellenique”, “Nuova Antologia” etj. Mes gjithë veprave të shumta të saj shquan trajtimi shkencor “Les femmes par une femme”. historinë e marrëdhënieve që kanë përcaktuar vendin e femrës në shoqëritë njërëzore ajo e ka paraqitur në mënyrë shkencore në këtë vepër.

Progresin e arritur dhe emancipimin e gruas ajo e përshkruan si matës i çdo shoqërie. Rolin e femrës në shoqëritë europiane ajo e analizon detajisht dhe kështu sqaron për fiset gjermanike që te këta fise gruaja ka qenë pronë për të cilën është kujdesur babai dhe në mungesë të tij vëllai i madh. Por këto fise janë dalluar prej të tjerëve sepse kanë respektuar në mënyrë të veçantë fjalën e femrës. Trajtim të gjërë për figurën e gruas shqiptare në kulturën europiane të shekullit të XIX nuk ka, por elementët të tjerë të kulturës shqiptare meritojnë një vëmendje të veçantë pasi dëshmojnë se cili ka qenë roli i femrës në shoqërinë patriakale shqiptare dhe sesi ato që ishin të integruara si Dora D’Istria kanë arritur të njihen gjithandej.

## II.3. Roli i gruas shqiptare në jetën shoqërore në atë kohë

Simbolika e femrës, si pasqyrimi real i rrethanave njërëzore ku iluzioni e zëvendëson realitetin, është si një përpëlitje që dëshira për ëndrra dhe shpresë të mos shuen. Realiteti zëvendësohet nga iluzioni nga ashpërsia dhe dhembëshmuria e tij. Edhe pse autori mundohet të zbresë në tokë, teksti mbetet i deshifruar në simbol. Ashtu siç konstaton edhe Bendeto Kroçe: *“Simboli është krijuar i pashkëputur nga intuita e autorit, ai është një sinonim i asaj intuete që ka shenjat e ideale. Për këtë, autori, bashkë me heroinën, përjetojnë iluzionin e një kohe tjetër, të lodhur, të pafuqishëm për ta mposhtur këtë realitet njërëzor. Jo rastësisht simboli i femrës vjen shfaqet e rishfaqet në veprën e Migjenit, gjithnjë “në kërkim të ëndrrës e në këto kërkime femra mbart kryqin e vuajtjeve, simbolin e dhimbjes e të shpresës”<sup>8</sup>.*

Femra si simbol i pafuqisë, është e shtypur në familje, poashtu edhe në shoqëri. Ajo tjetërsohet përballë kodit moral. Interesimi për botëpërceptimin femëror, ndjenjat dhe fantazitë përfytyruese të saj i shtojnë autorët ta trajtojnë me shumë kujdes figurën e femrës nëpërmjet personazhit letrar. Bota e saj e pasur dhe me plot të fshehta veçohet nga autorët për krenarinë, trimërinë, zgjuarsinë e bukurinë. Nuk ka vend tjetër ku mund të gjinden me shumë dashuri ndjenja dhe sinqeritet me tepër sesa në zemrën e një femre. Andaj këta autor gërmojnë në shpirtin e saj ndjesitë, dëshirat dhe energjitë shpirtërore të pashuara; hetojnë mendimet që ajo paraqet në lidhje të ngushtë me mentalitetin e kohës. Në këtë mënyrë krijohet individualiteti i saj.

Femra në veprat e Migjenit gjithmonë ka shpirtë bujar edhe pse nuk i përkrah proceset e tmerrshme shpirtërore dhe e mban barrën e rëndë të jetës. Si dhe atje në fshat ku njërëzit s’kanë mëshirë ndaj njërëzëve po kudrejt shtazëve po. Gruaja shqiptare është si ajo në tregimin, *“Qershijat”* ose si Dila në, *“Puthja e cubit”* njëherë vuan nga ana e natyrës së saj, që nuk mund ta shuajë urinë dhe e dyta shijon bukuritë e natyrës dhe një çast intim. Te dashuria e Agës me Lulit edhe pse Nushi e kishte paraparë një gjë të tillë që prindërit do të vërë pasurinë para çdo intersi i mbylli sytë para gjithë kësaj situate.

---

<sup>8</sup>Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006, fq. 195

Në shtëpinë e Oso Bakallit mbizotëron atmosfera e rëndë sepse po vdiste një e kaluar shekullore e me këtë do të fillonte një jetë e re edhe për gratë. Atij i duket që ka ardhur dita e fundit mbi tokë, se gratë do të dalin të zbuluara. Osoja e kundërshton këtë kështu që del një luftë tjetër e gruas shqiptare me shumë Oso Bakall tjerë. Femra në veprën e Migjenit është një femër që di të dashurojë të jetë e dashur edhe pse ka përpara pengesa. Dashuria nuk është e fortë nëse nuk has pengesa. Ajo kalitet me tepër forcohet dhe me pas shpërthen si vullkan.

Nga ku buron ky dëshprim i poetit? Cila është ajo grua që e dashuroi Migjeni? Nga shkrimet të tij e dimë që ka dashuruar, por s’e dimë se cilën. Dashuria e tij është e idealizuar sa që nuk duket që ka qenë për një femër të asaj kohe. Ndoshta Friden e Lenkën e Manastirit ndoshta Bojkën e Shkodrës ose ndonjë tjetër. Ne dimë prej penës së tij, se këto ndjenja e reflektojnë gjendjen e tij shpirtërore.

Migjeni e ka shkruar atë që është e vërtetë dhe reale dhe aspak s’e ka ekzagjeruar. Ai na njofton me karaktere të ndryshme dhe me fytyra të ndryshme grash. Fuqia e penës së tij vërehet kudo. Ai impresionon me këto karaktere dhe fytyra tipike të grave shqiptare. Pasi gratë shqiptare, sidomos ato të fshatit, ishin të mira vetëm për në shtëpi, shoqëria aspak s’u kujdes për emancipimin e tyre dhe për to në përgjithësi. Në një mënyrë të ashpër Migjeni e dënon shoqërinë me fatin e keq të gjinisë së butë, kudo që ai shkruan ose flet për gratë shqiptare. Gruaja në veprat e Migjenit s’ishte grua e degjeneruar nga vetëdëshira, por, sepse vetë jeta ia ka imponuar një gjë të tillë, siç thotë edhe studiuesi i veprës së Migjenit Dr. Petro Janura : *“Ajo mbeti si grueja e Ymer Agës ose si Penelopa e Homerit ose siç janë gratë e kurbetçinjëve të Sterio Spasses”*<sup>9</sup>.

Që kur është krijuar universi e deri në kohën tonë figura femërore ka patur një peshë të madhe, dhe pasqyrohet më së shumti në veprat artistike. Skulptura, piktura dhe letërsia femrën e ka ngritur përherë e më lart. Qoftë si nënë, si grua, si vajzë, për femrën kanë shkruar shumë poetë dhe gjithmonë shkëndija u ka ardhur nga dashuria.

Pasi ra në kurthin e dashurisë, Migjeni nuk i shpëtoj dot vuajtjeve, gëzimeve, atmosferës që ajo krijon. Sigurisht që këto ndjenja ai i hodhi në letër. Migjeni njohu dashurinë sublime, atë më të pastrën, më të shenjtën. Migjeni të gjitha format femërore, femrën prostitutë, murgeshë,

---

<sup>9</sup> Petro Janura. *Migjeni*, fq. 133 Flaka e Vëllazërimit Shkup 1979.

lypëse, engjëll i ravijëzon në veprat e tij. Përmes mendimit alegorik, simboleve, metaforave, ai kërkon t'i afrohet universit femëror duke tentuar ta zbulojë atë.

Nuk është e tepërt të thuhet se Migjeni ka arritur më së miri të krijojë universin femëror sipas syve dhe mendjes mashkullore. Në formën më moderne dhe klasike njëkohësisht Migjeni arriti të portretizonte të dashurat, mikeshat e tij. Engjëll dhe djall është femra, në të njëjtën kohë. Ajo dashuron dhe urren, të gëzon ose të bën të vuash.

## KAPITULLI III

### III. GRUAJA SHQIPTARE SOT

Rrugëtimi i popullit tonë nëpër histori, ku gruaja ka qenë pjesë aktive e të gjitha proceseve në mbrojtje të vendit dhe identitetit kombëtar është mbase shumë i gjatë. Mbretëresha Teuta është një shembëlltyrë më se e përsosur e gruas shqiptare ndër shekuj. Disa nga mijërat gra shqiptare që janë sakrifikuar për popullin shqiptar janë: Tringë Smajli, Shotë Galica, Marie Shllaku, Xhevë Lladrovci dhe këto janë vetëm një numër tepër i vogël për dallim nga numri i madh i femrave të cilat kanë qenë heroina të vërteta. *“Ato kanë qenë pjesëmarrëse në demonstrata, kanë protestuar në rrugë, kanë luftuar në radhët e UÇK-së, kanë qenë në politikë, por ato nuk i ka ditur Përfundimi dhe askush nuk i ka treguar”*, thotë Anna di Lellio.

Gjendja e gruas ka qenë shumë e rënduar, jo vetëm nga robëria shumëvjeçare por më së shumti nga dominimi i patriarkalizmit tradicional. Por roli i gruas në shoqërinë tonë, në kohën tonë po ndryshon dhe po që ka filluar të vlerësohet shumë më shumë. Me qëllim të emancipimit cilësor të shoqërisë dhe me reforma, sidomos në arsim, ku prioritet do të ketë femra, ngase arsimimi i një femre është arsimim i një shoqërie të tërë, përparimi dhe emancipimi i fëmijës do të sjellë dobi të jashtëzakonshme.

Për arsimim të barabartë të fëmijës dhe të mashkullit, shumë shtete kanë aprovuar ligje të veçanta që e garantojnë këtë. Ndër prioritetet tjera pritej të ishte edhe zhvillimi i politikave që duhej ta nxisnin pjesëmarrjen e gruas në politikë është ndër prioritetet e tjera, ngase edhe pozitat e vendimmarrjes janë shumë të rëndësishme dhe me siguri që ato pozita duhet t'u sigurohen edhe grave.

Edhe pse në institucionet që në formim janë dominuar nga burrat, për fat të keq, tani është koha kur shumë gjëra kanë ndryshuar, dhe ndër ato është edhe kjo. Por, shumë gra të guximshme

dhe ato që tani më kishin dëshmuar kulturë intelektuale e atdhetare, u zëvendësuan me gra të zakonshme, të cilat kishin për t'u dukur vetëm si dekor. Femra shpeshëherë duhet t'i nënshtrohet botës mashkullore se përndryshe s'ka asnjë mundësi për sukses. Prandaj thënia e Gandit ka shumë vlerë dhe me të vërtetë duhet të respektohet dhe të zbatohet vazhdimisht nga gjinia mashkullore:: *“Në qoftë se në shoqëri prania e femrës nuk shërben për gjë tjetër, por vetëm për të kënaqur pasionet e burrave, ne të gjithë në emër të burrave duhet ta ulim kokën nga turpi”*<sup>10</sup>.

Roli dytësor është i pranishëm edhe në këtë kohë, në kohën e demokracisë, edhe pse të gjithë duhet të jemi të barabartë dhe gratë shumë më pak e ndjejnë demokracinë e vërtetë. Si e drejtë njerëzore është edhe e drejta për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse e jo gratë të jenë veç numër apo kukull për argëtimin e politikanëve. Fatkeqësi e madhe është që në viset shqiptare si dhe në të gjithë balkanin, shoqëria dominohet nga burrat, dhe gratë merren me politikë vetëm kur ato lejohen ose u duhen burrave. Gruaja me çdo kusht duhet ta marrë timonin e udhëheqjes me veten dhe sikur burrat, të ketë rol drejtues në shoqëri. Potencialin e gruas në këtë rol, do të dëshmohet me disa shembuj domethënës.

Në shumë vende të botës u hapën debate rreth pjesëmarrjes së gruas në politikë gjatë viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Si rrjedhojë pati një ngritje të lehtë të pjesëmarrjes së gruas në këtë fushë. Ndërsa sot vërehet se femrat janë bërë forcë e fuqishme e ndryshimit, edhe pse segregimi vertikal dhe horizontal ndaj saj vazhdon dhe kultura e dominimit të mashkullit apo patriarkalizmi tradicional, janë ende shumë të fuqishme. Për kufizimin e të drejtës së gruas të shkaktari kryesor është burri. Me aplikimin e kuotës gjinore për promovimin e femrës në politikë, vetëm sa është dëshmuar gjendja e mjerueshme në të cilën ndodhet gruaja sot. Kuota aspak nuk e ka zbehur diskriminimin, përkundrazi, ka favorizuar gratë me më pak aftësi, për këtë shkak është edhe kundërproduktive.

Kjo duhet të rregullohet me ligj ngase nuk mund të ketë barazi gjinore pa pjesëmarrjen e gruas në politikë. Shqiptarët në shoqërinë e kësaj kohe, duhet ta zhbëjnë nga mendësia e tyre trajtimin tradicional të gruas. *“Është nevojë e ngutshme për përmirësimin e gjendjes së gruas”*, thoshte Sami Frashëri. Gruaja, gjatë viteve të fundit ka dëshmuar se është e zonja për ta drejtuar shtetin dhe t'i çojë proceset përpara, për këtë shkak edhe duhet të vlerësohet si qenie më aktive

---

<sup>10</sup><https://www.radiokosovaelire.com/elif-luzha-gruaja-shqiptare-dhe-sot/> (05.04.2020)



e njerëzimit. Para së gjithash, prania e grave në politikë do të krijonte një ambient më paqësor dhe të pakorruptuar. Duke dëshmuar vlerat më të përkryera, energjinë dhe kreativitetin, ka arritur koha kur gratë duhet ta përdorin këtë mundësi për të mirën e tyre dhe të gjithë shoqërisë.

### **III. 1. Dallimet e shprehura në jetën shoqërore sipas Migjenit atëherë dhe tani**

Të dhënat faktike që historia na ofron, të cilave gjithmonë duhet referuar, tregojnë se gruaja ka bartë një barrë të rëndësishme në ndodhitë e shumta shoqërore dhe ndryshimet që ka pësuar ajo, ndërsa burri gjithmonë i ka gëzuar lavdatat dhe meritat. Vetë fakti që gruaja është trajtuar si shërbyese nga ana e burrit, i është nënshtruar atij dhe gjithsesi ajo është trajtuar si qenie e dorës së dytë, dhe sikur të jetë e destinuar vetëm për të lindur. Por nuk ka qenë e pranishme kjo dukuri vetëm te ne shqiptaret ose në Ballkan, por mbarë botës, edhe pse ndryshimi në shumë vende të tjera ka ardhur shumë më heret se sa te ne. Edhe pse te ne ka zgjatur me shumë ky dominim i gjinisë mashkullore, kjo gjë ka qenë e pranishme edhe në shumë vende tjera dhe në disa vende akoma vazhdon të dominojë.

Të drejten e votës, nëse iu kthehemi të dhënave historike, do të vërejmë që si në Europë po ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gratë e kanë fituar vonë, në shekullin e kaluar, që nuk është shumë larg por shumë vonë. Por, jo rrallë, më rrjedhat e historisë, gratë janë bërë ndër faktorët më të rëndësishëm dhe me siguri që ndikimi i tyre ka qenë shumë i vlefshëm. Në të vërtetë, gruaja, është një qenie e ndjeshme, subtile dhe intelektuale, dhe shikuar nga një këndvështrim tjetër, shumë më domethënës, shumë më të natyrshëm dhe më human, gruaja nuk duhet trajtuar, dhe nuk është trajtuar gjithmonë vetëm si një objekt a një qenie por ajo është pjesë e rëndësishme dhe e barabartë e çdo shoqërie.

Ndër shekuj ajo është edhe frymëzim i sa e sa artistëve të të gjitha gjinive, gjithandej nëpër botë. Ajo është nënë, dhuruese jo vetëm e dashurisë, kujdesit dhe jetës por është, në saje të attributeve që përmendëm dhe bukurisë femërore. Artistët më të mëdhej nga e kaluara e deri në ditët e sotme poashtu edhe tek krijimet më të hershme popullore-artistike, gruaja si femër dhe

nënë, kanë qenë model i krijimeve më të bukura të skulptorëve, piktorëve, kompozitorëve e regjisorëve më të shquar dhe më të njohur të botës.

Në veprën e Migjenit problemi i gruas është një tragjedi në vete, është pjesë e tregjedisë së popullit. Këtë tragjedi ajo e ndjeu më shumë në kurrizin dhe në jetën e saj familjare për këte arsye vendosa që ta trjatoi në menyrë të veçantë. Migjeni i përshkruan gratë të mbyllura në botën e vet. “*A do qymyr zotëri*” tregimi i Migjenit na paraqet një malësore të re dhe të ndershme, e cila bie vktimë e gjendjes së saj ekonomike dhe e epsheve të një pasaniku johuman. Kjo malësore e re dhe e bukur, e cila asnjëherë s’ka menduar për jetën intime të saj dhe besonte se njërëzitet janë të ndershëm. U detyrua të njohë botën e saj intime për shkak të krizës së bukës ku familja e saj e detyroi të shesë qymyr e jo të kërkojë misër.

Këtë fat e përjetoi e dhe Lukja e cila, “*blihej prej njëzëve me pare në dorë*” por për këtë dhembje shpirtërore ajo dinte të tallej me simpatizantët e vet. Por edhe ajo donte të jetonte me nder si të gjithë njërëzitet tjerë. Migjeni shpirtmirë dhe human që njohu plagët shoqërore i mbron edhe këto gra fatkëqia, që duke u shitur bëhën shumë të njohura. Këtë dukuri të vërtetë e të rëndomtë, këtë realitet të hidhur, ku mbisundojnë korrupsioni, imoraliteti dhe vuajtja, poeti e paraqet filozofikisht. Migjeni po që ka qenë analizues i mprehtë me sy të lartë kritik i jetës shoqërore dhe shpirtërore. Gjendjen shpirtërore të gruas prostitutë dhe të grave të zotërive ai i analizon nëpër antitezë.

Nëse iu referohemi këngëve popullore, rrëfimeve gojore por edhe vetë historisë, femra shqiptare, edhe pse në shikim të parë nuk është trajtuar si duhet dhe sa duhet, ajo qoftë si vajzë e re, nënë e përkushtuar a motër e gatshme për t’u sakrifikuar për të vëllanë dhe jo vetëm, ka gëzuar respektin e duhur dhe mirënjohjen e madhe prej njërëzëve të mençur dhe artistëve e rrëfimtara të popullor, duke u shndërruar kështu në modele admirimi e referimi për brezat e ri, se ka qenë pjesë e rëndësishme dhe e dobishme për shoqërinë.

Me përzierjen e kulturave të ndryshme ndër shekuj, si pasojë e okupimeve të gjata, dhe nëse i marrim parasysh rrethanat historike në të cilat është zhvilluar shoqëria shqiptare dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ndër vite atëherë del se edhe gruaja shqiptare, ka reflektuar një mençuri të madhe, është sakrifikuar por edhe ka luftuar për të drejtat jo vetëm të saj si pjesë e shoqërisë, por edhe e të gjithë kombit, duke pasur gjithmonë një ndjenjë sakrifice për familjen,

mjedisin e kombin por edhe gatishmëri që të gjitha atributet fizike e intelektuale ti shkrijë në favor të një mirëqenie të përbashkët.

Modele të gruas luftëtare për të drejtat e vendit e popullit, ka krijuar e kaluara jonë e cila është përplot me histori sakrificash të grave, dhe po këto gra kanë qenë frymëzim i këngëtarëve e artistëve më të njohur të kombit; Mbretëresha Teutë, Tringë Smajli, Shotë Galica, Dora D'Istria, Musine Kokallari dhe të tjera. Nuk mund t'i përmendim, se janë të shumta në numër, edhe nga rëndësia edhe nga vlera e tyre, nga shumë fusha të ndryshme është shumë e vështirë të veçohen. Por nënat tona, të gjitha, është e pamundur të veçojmë asnjëren prej tyre, edukuan breza të tërë duke u sakrifikuar si nëna të mira, të dashura, punëtore, si amvise të shkëlqyera, si punëtore e bashkëshorte shembullore, që më në fund padrejtësisht të vlerësohen: të papunësuara. Por nuk ka qenë punë, puna e tyre në shtëpi, duke rritur fëmijë, duke punuar në ara e livadhe, duke shërbyer të gjithë anëtarët e shtëpise, ato fare nuk kanë punuar.

Duke filluar prej viteve gjashtëdhjeta e këtij erdhi një kohë tjetër. Filloi ngritja e saj në shoqëri por gradualisht. Në gjitha fushat e veprimit ekonomik, politik, shoqëror por dhe të tjera, gruaaja filloi të kërkojë të drejtat e saja për t'u realizuar dhe për t'u barazuar me gjininë mashkullore në të gjitha aspektet. Por, për shkak të paragjytimeve të cilat akoma nuk janë shuar tërësisht, për egoizmin, për shkak të luftës për pushtet, prepotencës mashkullore, këto të drejta realizohen pjesërisht dhe me një tempo shumë të ngadaltë.

### III.2. Kuadri shoqëror i ndryshimit për gratë shqiptare

Shikohet qartë lëvizja e lirë e femrës në ambientet sociale, të punës, politikës, ekonomisë, gjë që paraqet dhe tregon për prezencën dhe pjesëmarrjen e gruas në shoqërinë shqiptare se është rritur ndjeshëm. Mentaliteti gjithsesi akoma nuk ka ndryshuar ngase barazia e plotë ndërmjet gruas dhe burrit akoma nuk është e arritur në shoqërinë shqiptare, dhe e gjitha kjo për shkak të tipareve tradicionale patriarkale. Zhvillimet kulturore dhe evoluimi i shpirtit të njerëzve janë gjëja më parësore nga e cila varet roli i gruas shqiptare në shoqëri.

*“Në etapat e zhvillimit njerëzor, më të rëndësishme janë etapat e shpirtit njerëzor gjatë gjithë historisë, dhe një rol të veçantë dhe të rëndësishëm për këtë, ka patur dhe ka prania e gruas në mbarë shoqërinë njerëzore. Çdo ditë e më shumë ndodhemi përballë shumë sfidave dhe fenomeneve që shoqëria e sotme po i shfaq me shumë agresivitet”<sup>11</sup>.*

Për të ofruar më të mirën e saj si femër sot, duke qenë vajzë, grua, bashkëshorte, në familje dhe shoqëri ajo duhet të jetë prezente, aktive në rolin e saj dhe me dashuri, përkushtim dhe përgjegjësi të ofroje modelin dhe kontributin e saj.

Për të patur breza pasardhës në paqe për një shoqëri më të mirë, ne duhet të kultivojmë pa u lodhur të fëmijet tanë paqen, dashurinë dhe harmoninë. Roli ynë si gra është shumë i rëndësishëm ngase sot ne gjendemi të përfshirë në shumë konflikte, debate dhe pasiguri.

Për një jetë më në paqe, dhe një të ardhme për fëmijët tanë, çdo grua shqiptare ka një përgjegjësi të madhe për të mos rreshtur kurrë së ofruari si në familje, profesion dhe shoqëri, dhe kjo kërkon shumë energji dhe kurajo. Vetëm kështu ne do të jemi të vlefshme në shoqëri, në familje, në profesion dhe kudo, duke bërë të mundur përballjen me sfidat e realitetit të shoqërisë shqiptare. Duke pasur nevojë për një jetë më të mirë, me bashkëpunim dhe me dialog, ne duhet të ofrojmë gjithmonë më të mirën prej nesh. Nuk do të bëhemi pjesë e barabartë e shoqërisë pa këto.

---

<sup>11</sup>[https://perqasje.com/2016/03/roli-i-gruas-ne-shoqerine-shqiptare/\(28.03.2020\)](https://perqasje.com/2016/03/roli-i-gruas-ne-shoqerine-shqiptare/(28.03.2020))

Gjatë shekujve të rëndë të robërisë, historia jonë kombëtare është e mbushur përplot shembuj të heroizmit të femrës shqiptare. Roli dhe kontributi i saj në periudha të ndryshme historike për lirinë e atdheut është shumë i rëndësishëm. Është fakt i pamohueshëm se femra shqiptare, duke filluar që nga periudha ilire e këndeje, zë një vend të rëndësishëm në historinë kombëtare të popullit tonë.

Me dinjitet e fisnikëri të lartë, femra shqiptare gjatë gjithë historisë, është dhe ka qenë e zonja që gjithmonë të mbajë lart flamurin e qëndresës dhe të familjes. Rruga duhet vazhduar edhe pse gratë shqiptare, motrat, bijat dhe bashkëshortet tona, luftë pas lufte, kanë marshuar krenare së bashku me gjininë të kundërt, dhe kështu arritën deri këtu, dhe do arrijnë shumë më shumë në vitet në vijim. Gjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë të historisë, falë femrës shqiptare, populli ynë arriti që të shpëtojë nga asimilimi, duke ruajtur në të njëjtën kohë gjuhën, historinë, traditën, kulturën dhe përkatësinë tonë kombëtare. Në rrethanat më të përshtatshme historike ajo gjithmonë inkuadrohet në rrjedhat që i imponohen nga vetë faktori kohë. “Burrat trima lindin dhe rriten vetëm nga nënat trimëresha”, thotë një fjalë e vjetër popullore.

Femrat shqiptare, nëse i shfletojmë faqet e historisë, gjithmonë i gjejmë pjesëmarrëse aktive në luftërat e vrullshme të kryetrimt Skënderbeu. Në vitin 1450, gjatë rrethimit të parë të Krujës kur në Shqipëri ka erdhur sulltan Murati i II me ushtrinë otomane, Skënderbeu kish urdhëruar të zbrazej qyteti nga gratë, fëmijët dhe pleqtë dhe të mbeteshin vetëm luftëtarët, që duhej të mbronin kështjellën deri në vdekje. Për këtë ngjarje humanisti i njohur Marin Barleti shkruan: *“kur dhembja u ul pakëz e ngopur prej lotëve, nënat u kthyen nga djemtë e tyre... dhe me fjalë të përsëdytura iu epnin porosi krenare”*, dhe kronisti venedikas i asaj periudhe legjendare, A. Sabellico, më 1478 shkruan: *“në mes të zjarrit të luftës, kur çdo gjë shungullonte nga armët e barbarëve, në ato qytete ku Skënderbeu kishte mbretëruar, grupe vajzash e kishin zakon që në çdo tetë ditë të mblidheshin e të këndonin lavditë e princit të vdekur, ashtu siç bënin të moçmit për heronjtë e mëdhenj”*.

Femra shqiptare ishte aktive edhe atëherë, edhe pse në një mënyrë tjetër e luftonte armikun - me armën e kurajos që u jepte luftëtarëve., ngase nuk dilte në fushën e betejës. Për kthesa të mëdha për femrën shqiptare, theksohet si shekull, shekulli XV duke pasur parasysh normat morale e juridike të vendosura gjatë shekujve mesjetarë. Ndersa në shekullin XIX gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare femrën shqiptare e gjejmë edhe më aktive. Në këtë periudhë ajo

me armë në dorë merr pjesë në luftërat për liri e pavarësi, atë e gjejmë me armë në dorë duke mbrojtur çështjen e atdheut dhe me këtë dëshmoi se nuk ishte vetëm nënë e bashkëshorte e mirë.

Burri këshillohet me të jo vetëm për punët e familjes, por edhe për çështjet e vendit edhe pse femra gjithmonë ka qenë e nënshtuar ndaj tij dhe kjo gjë vlen për të gjitha gratë shqiptare, qoftë myslimane, qoftë e krishterë dhe këtë e dëshmon historia jonë kombëtare. Edhe kur janë përpara njërëzve të tyre më të shtrenjtë të shtrirë për dhé, shpeshherë duke mbajtur nëpër duar edhe kufomat e tyre, femrat shqiptare të forta dhe krenare, dinë t'i mbajnë lotët e dhembjes.

Në luftërat për çlirim kombëtar të atdheut, femra shqiptare ishte pjesëmarrëse aktive sidomos në kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912. Me informata e kurajo, qindra femra shqiptare ndihmuan kryengritjet me mjete e me strehim. Në ato vite revolucionare femra shqiptare nuk qëndroi vetëm në prapavijë. Ajo kaloi edhe në vijën e zjarrit me një guxim të rrallë. Me armë në dorë në Grykën e Kaçanikut, ballëpërballë armikut dolën femrat kosovare. Femrat e Malësisë së Mbi – Shkodrës e të Dibrës e ndoqën shembullin e tyre. Femrat dolën në luftë anekënd Shqipërisë, aty ku kishte nevojë dhe ku buçiste lufta.

Ndërmjet kryengritësve shqiptarë, historia jonë dëshmon se kishte edhe femra. Në luftimet që u bënë në rrethet e Tuzit kishte edhe femra të veshura me rroba burrash, bile disa nga këto kanë treguar edhe trimërinë e tyre, aq sa të kalojnë në radhët e para të luftës. Me krenarinë shqiptare, femra jonë shqiptare nuk e ka duruar kurrë tradhtinë dhe pabesinë ndaj atdheut, qoftë si nënë, motër, bijë apo bashkëshorte.

Virtytet e femrës shqiptare ishin frymëzim i luftërave për liri të atdheut. Me respektin më të lartë ajo te shqiptarët trajtohet, dhe vërtet punon në shtëpi, por zë një vend të nderuar në shoqëri dhe se jeta e saj fisnikërohet me të qenit nënë. Është e vërtetë se ajo vlerësonte dhe vlerëson edhe sot shumë lartë të qenit nënë dhe bashkëshorte. Edhe pse ndërtimi i gjithë jetës së saj kanë qenë në këto dy shtylla kryesore, por edhe jo rrallëherë ajo ka dëshmuar se që të dyja i sakrifikon për liri, gjë që e barazon me heronjtë.

Femra shqiptare në asnjë periudhë, gjë që duhet theksuar, kur ishte vendi në rrezik nuk qëndroi duarkryq., sidomos që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit duhet përmendur edhe luftërat këndeje, shembujt e pjesëmarrjes së femrës shqiptare në luftërat për liri janë të shumta. Këto cilësi të rralla morale të saj, ky atdhetarizëm i njohur i gruas shqiptare morën një përmbajtje të re edhe

gjatë Luftës së Dytë Botërore u shfaqën me forcë në ato gra e vajza të popullit që ngjeshën amët dhe luftuan krah për krah me burrat.

Në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, krah për krah me burrat u ndodhën edhe femrat shqiptare të cilat u shfaqën edhe në krye të detyrës duke organizuar fillimisht grupe e organizata ilegale e më vonë morën pjesë në demonstratat gjithëpopullore të vitit 1968, 1981, 1989. Dolën edhe në male me formimin e UÇK-së duke u bërë pjesë e denjë e luftës për liri. Femrat shqiptare përballuan me stoicizëm promethean tufanin e egërsuar shovinist pansllav. Luftën në Kosovë e fitoi nëna shqiptare duke përballuar të gjithë plagët dhe dëmet e mëdha që iu shkaktuan, ajo përsëri triumfoi mbi egërsinë e armiqve pushtues. I mposhti planet sllavizuese të Karagjorgjeviqëve, Pashiqëve, Andriqëve, Rankoviqëve, po kjo femra shqiptare.

Populli shqiptar shpeshherë u përgjak, e mori edhe flakë, edhe plagë të shumta, por gjithmonë eci, ec dhe do të ecë përpara. Migjeni duke parë vuajtjet e skamjen e shumicës shqiptare, duke qenë edhe vetë bashkëvuajtës e bashkë-skamnor, ai i satanizoi dhe i diskreditoi me aq sa mund të bënte këtë punë një poet, domethënë nuk qëndroi vetëm tek identifikimi i këtyre, por me penën e tij iu shpalli luftë duke dëshmuar gjenin e tij të pastër njerëzor e kombëtar.

Në përshkrimin realist të gjendjes shoqërore të Shqipërisë asnjë poet tjetër i kombit shqiptar në kohën kur jetoi poeti, nuk ka qenë aq diskret. Migjeni dispononte një botë të veçantë të ndjesive gjë që e dallonte nga të gjithë poetët shqiptarë të kohës. Migjeni altruist dhe humanist, njeriu që vuante me të gjithë të vuajturit e botës, kjo gjë në thellësi të shpirtit të tij kryengritës jetonte, sepse në vuajtjet e tyre identifikonte vuajtjet dhe mjerimin njerëzor, vuajtjet e njerëzve që nuk arrinin t'i shijonin të mirat dhe kënaqësitë e kësaj bote.

Migjeni vuante me vuajtjet e nxënësve, ai merrej me hallet dhe brengat e punëtorëve e të fshatarëve, por gjithmonë gjente mënyrë për të shprehur së degjenerimin. Migjeni në jetë dhe në vepër ka qenë humanist, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar, i gatshëm për t'u sakrifikuar për të mirën e përgjithshme. Po ashtu çdo padrejtësi të denonconte dhe të stigmatizonte, ai ka qenë i gatshëm çdo mashtrues e abuzues t'i shpalosë, sepse vetë në shpirtin e tij ka qenë njëri i drejtë dhe i dashur, kishte shpirt dhe bindje të intelektualit të shkolluar e të emancipuar, domethënë nuk është shkak për këtë vetëm fakti që ka qenë një tip i veçantë dhe i padjallëzuar.

Migjeni kishte pranuar jetën e Sokratit të vuajtur, e jo të dërrit të kënaqur duke qenë i vetëdijshëm se pozita e intelektualit të njëmendtë nuk është rehatia e tij shpirtërore dhe përfitimi personal.

Këngët e tij të “këndueme” e të “pa këndueme” ia ka kushtuar njëriut të thjeshtë, që mundahej ta gjente rrugën e mbijetesës, përpiquej të ecë në rrugën e njërëzisë, rrugë e cila trasohej me shumë mund e sakrifica. Dhe ato këngë ishin djepi ku ai flinte dhe rehatohej për një çast, por edhe arkivoli ku do t’i pushonin eshtrat në përjetësi. Migjeni me vuajtje e mjerime kaloi rrugën e tij të shkurtër jetësore, duke u ballafaquar me grushtet e rënda të jetës. Ai vuante edhe me mjerimin e të tjerëve, vuante me vuajtjen e të gjithë të mjerëve të kësaj bote. Migjeni pasqyron vuajtjen në mënyrë reale ashtu siç ishte në realitet prandaj edhe paraqitet si realist i mirëfilltë. Duke vuajtur për njerëzimin ai gjithmonë i mban dhe i paguan vuajtjet e popullit të tij.

Migjeni krijoi një diskurs të veçantë komunikativ me lexuesin e kohës kur jetoi dhe veproji, dhe nuk mund të ishte ndryshe ngase nga gjendja e tillë shpirtërore, i trajtuar keq materialisht dhe i sëmurë nga kushtet e rënda të jetës, ai kishte vizion të fuqishëm artistik. Sfidat kundër të ligave të shumta ishte e rëndë dhe shumë e pabarabartë, dhe këtë shumë mirë e dinte Migjeni se ka qenë vetë i sfiduar. Luftën kundër të ligave dhe kundër padrejtësive ai ishte i vetëdijshëm po ashtu se nuk do ta fitonte. Heshtjen ia preferonin si shokët, motrat, shëndeti i dobët dhe të gjithë ata që e donin. Poashtu edhe regjimi kërkonte që ai të heshte. Tërë asaj bote të zhytur në padituri, në skamje e mjerim kish te çaste dëshpërimi kur edhe vetë Migjeni fizik i thoshte, hesht, Migjenit krijues, por nuk i bënte dot shpirti për të heshtur para tërë asaj katrohure. Poeti nuk mund të heshtë, për atë shkak edhe në frymët e fundit kishte shkruar tri radhët e fundit të shënimi “I fundi Skanderbe” :

*“Ku janë orat dhe muzet? Shtojzovallet e zanat ku janë?*

*S’ po flitet ma për vallet e tyne, As për sytë e tyne që të shitojnë, as të bajnë fatbardhë,  
S po flitet ma!”<sup>12</sup>*

---

<sup>12</sup><https://www.radiokosovaelire.com/millosh-gjergj-nikolla-1911-1937-poeti-e-prozatori-nder-te-njohurit-e-letersise-shqipe/> (26.04.2020)



## KAPITULLI IV

### IV. GJENDJA SOCIALE NË KOHËN E MIGJENIT

Bindjet të përparuara për kohën e tij, të cilat i posedonte Migjeni dhe me të cilat filloi të formohej që në bankat shkollore ishin shkak nga ndikimi i veprave të autorëve përparimtarë. Kur në letërsinë shqiptare po forcohej rryma demokratike ai filloi me punën e tij si shkrimtar realist, thellësisht e ndryshme nga brendia dhe forma, dhe për këtë dha ndihmë të madhe në zhvillimin të mëtejshëm të letërsisë realiste.

Aspirata për një botë të re, ku njërëzit e thjeshtë të jetojnë të lirë dhe të lumtur, pa frikë për të nesërmen dhe me dinjitet njërëzor qëndron si themel në veprimtarinë e Migjenit. Ky humanizëm aktiv përshkon tej dhe e ndan veprën e tij. Ëndrra e autorit për një të ardhme të bukur u shpreh me figura të gjalla romantike në poezitë e para, si "Zgjimi", "Të birt' e shekullit të ri", "Shkëndija", "Shpirtënit shtegtarë", etj. poashtu aty e shprehu edhe pakënaqësinë e thellë ndaj realitetit çifligaro-borgjez. U ngrit poeti kundër amullisë shoqërore dhe forcave që mbanin vendin në errësirë. Gjendja e rëndë e vendit u gërshetua në këto vepra me kritikën e rreptë dhe me dëshirën e zjarrtë për ditë më të bukura *"një agim të lum e të drejtë kombëtar"*. Kalimi i tij i shpejtë nga romantizmi revolucionar në realizmin kritik është karakteristikë e zhvillimit të Migjenit si shkrimtar.

Vend qendror në botimet e Migjenit zë pasqyrimi i varfërisë së thellë të masave dhe për shkrimtarin kishte rëndësi të madhe shoqërore që të dilte në dritë sa më qartë humnera e vuajtjeve, ku e kishte hedhur popullin regjimi reaksionar. Ishin të papunë që rropateshin gjithë ditën për të nxjerrë kafshatën e gojës, heronjtë e veprave të tij më të mira ("Bukën tonë të përditshme falna sot", "Bukuria që vret", "Mollë e ndalueme", "Legjenda e misrit", "A don qymyr zotni?", etj.),

malësorë që qëndronin në zgrip të jetës, të mjerë që nuk u kishte ecur në jetë dhe ishin flakur jashtë shoqërisë.

Në veprën e tij më të shquar "Poemën e mjerimit", Migjeni përshkroi në tablo të gjallë dhe rrëqethëse të gëlltitjes së vështirë të masave të shtypura dhe të shfrytëzuara, që veniteshin fizikisht nën grushtin e mjerimit i cili mbrohej nga monarkia çifligaro-borgjeze dhe sundonte në vend. Migjeni fshikulloi ashpër indiferentizmin e klasave të kamura të vargjet si "Zoti të dhashtë" etj., ndaj vuajtjeve që hiqte populli. Migjeni i pasqyroj shtresat e privileguara kryesisht në jetën e tyre vetjake, ai poashtu edhe e pasqyron moralin hipokrit dhe despotizmin që karakterizonte marrëdhëniet e tyre familjare ("Të çelen arkapijat", "Studenti në shtëpi"). Si forcë e paaftë për të luftuar për ideale të larta të "Studenti në shtëpi" ai vuri në lojë inteligjencën borgjeze. Artin dhe shtypin zyrtar ai i goditi haptazi dhe me forcë të "Kanga skandaloze", "Programi i një reviste", "Novelë mbi krizën", etj. Migjeni i pasqyroj me simpati të thellë skamnorët, të cilët i urrenin shtypësit, por ende nuk guxonin të ngriheshin kundër tyre.

Shkrimtari vuri në dukje aftësitë intelektuale të masave dhe dëshirën e zjarhtë për ndryshime në gjendjen e tyre shoqërore në skicat "Luli i vocërr" dhe sidomos të "Zeneli", Shfaqjet e protestës së tyre ndaj padrejtësisë shoqërore sado të zbehta që janë, ai i përshkruan të "Mollë e ndalueme". Prirja për t'i dhënë personazhet me disa viza, rrëfimi i thjeshtë dhe konciz, imtësitë, psikologjizmi i hollë, fryma polemike që zbuljnë thelbin e dukurisë, ironia dhe figurat poetike shprehëse janë veçoritë kryesore të stilit të Migjenit dhe shkrimet e tij lanë gjurmë të dukshme në letrarët e rinj të kohës.

Me aspiratën e fortë për një të ardhme më të mirë për masat e popullit dhe mohimin e shoqërisë çifligaro-borgjeze, Migjeni me veprat e tij ndihmoi në formimin shpirtëror dhe pati ndikim të ndjeshëm në rrethet e rinisë përparimtare. Këtë rol ato e luajtën edhe në vitet e qëndresës kundër pushtuesit fashist, kur qarkullonin dorë më dorë.

Trashëgimi letrar i Migjenit u bë i njohur plotësisht pas Çlirimit. "Veprat" e plota të Migjenit janë botuar tre herë: 1954, 1957, 1961, kanë dalë edhe një varg botimesh të tipave të ndryshëm. Për jetën dhe shkrimet e tija janë botuar studime e artikuj të shumtë. Shkrimet poetike dhe në prozë të Migjenit janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.

Eshtrat e Migjenit u sollën në atdhe në vitin 1956 me interesimin e Republikës Popullore të Shqipërisë. Post-mortem, në vitin 1957 atij iu dha edhe titulli "Mësues i Popullit".

Krijimet e shumicës e shkrimtarëve, nga artdashësit e letërsisë vazhdojnë të lexohen edhe sot për arsye se posedojnë diçka të ngjashme me atë të cilën e jetojnë. Njëri ndër shtyrësit kryesor të leximit të një vepre qoftë roman, prozë apo poezi është aktualiteti; përkimet në mes të asaj se çfarë ka ngjarë në një periudhë të caktuar kohore më parë dhe asaj që ndodhë në ditët e sotme. Të një periudhe të caktuar të popullit shqiptar janë pasqyrë "Vargjet e lira" dhe ato përfaqësojnë një të kaluar shoqërore. Nëpër poezitë e kësaj vepre mund të ndjesh vetëm pjesët e një të kaluare e cila nuk paraqitet e lavdishme por mjeruese edhe pse nuk mund të gjejmë diçka jashtëzakonisht aktualizuese. Përshkrim i plotë i mënyrës së jetës janë "Vargjet e lira" vuajtje, mundime, mjerim, dëshpërim e shumë dukuri të tjera që pasonin si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e realitetit të hidhur, skamjes dhe ambientit politik. Aktualiteti i Migjenit është më i zbehtë në shoqërinë tonë sot dhe këtë e ka bërë faktori kohë, ngase me kalimin e kohës populli shqiptar ka arritur ta nxjerrë vetën nga ajo fundërrinë ku kishte qenë.

Realiteti i Migjenit është krejt ndryshe nga realiteti i sotëm i popullit shqiptar. Vepra e Migjenit e shkruar në atë kohë dhe në atë shoqëri edhe sot e kësaj dite mund të quhet se e pasqyron realitetin e kohës sonë edhe pse në ditët e sotme ky mjerim maskohet. Për veprën e Migjenit mund të konstatojmë që nuk i takon një kohe por është vepër univerzale e të gjitha kohërave. Migjeni është aktual, mirëpo në një raport me të zbehtë dhe këtë e konstatojmë për këto dy fakte të cilat janë probleme shoqërore aktuale. Migjeni mbetet unik në atë që ka trajtuar në poezitë e tij.

## IV.1. Pasqyrimi i gjendjes sociale në prozë

Migjeni trajtoi problematikën në publicistikën dhe në prozën përparimtare të kohës në tregimet e në skicat e tij. Në zbërthimet e thella dhe përgjithësimet e mëdha të Migjenit, në krijimet me një nivel shumë të lartë artistik, qëndron ndryshimi. Tregimi i realizmit kritik shqiptar njohu kulmin e tij me Migjenin. Pasqyrimi i jetës së fshatit dhe qytetit shqiptar në problemet më thelbësore dhe dramatike të saj, me tregimet "A don qymyr zotni?", "Studenti në shtëpi", "Të çelën arkapijat", "Historia e njënës nga ato", "Qershijat", "Bukën tonë të përditshme falna zot", qëndrojnë përkrah poezisë së tij më të mirë.

Me të njëjtën forcë artistike si në poezi ashtu edhe në prozën e shkurtër është Migjeni që u shfaq si krijuesi i vetëm i letërsisë sonë të së kaluarës. Me tregimin e tij në letërsinë shqiptare motivohet për herë të parë plotësisht në art problemi i shkatërrimit të personalitetit të njëriut në kushtet e një shoqërie despotike. Si në poezitë e tij, që vlerat shpirtërore e morale shkatërrohen në kushtet e mjerimit e vuajtjeve të shumta të jetës së shtresave të varfëra, poashtu edhe në tregimet e skicat, ashtu rrihet vazhdimisht ideja se jeta shpirtërore kushtëzohet nga jeta materiale.

Ai tregon se si dinjiteti legjendar i malësorit, nderi i malësorës, dhe i qytetares së varfër kanë marrë fund në luftën për ekzistencë në vështirësinë për t'i siguruar fëmijës një copë bukë a për ta shpëtuar nga vdekja, dhe këtë ai e tregon me dhembje dhe revoltë. Nëna që mallëkon pjellën e vet e që detyrohet të shesë vetveten, punëtori i papunë, e reja dhe i riu të cilëve jeta patriarkale, me ligje e norma mesjetare, u than ndjenjat, shpresat dhe ëndrrat rinore, malësori që i ka harruar hyjnitë e tij dhe i përgjërohet kokrrës së misrit, këto janë personazhet e Migjenit.

Migjeni trajtoi problemet më të rëndësishme të kohës, në tregimin e tij dhe u bë shprehës i kontradiktave të saj. Personazhet e tij janë tipizme të plota të një shtrese të caktuar të shoqërisë së kohës. Ai i krijon me detaje dhe me anë të zbërthimeve të thella psikologjike personazhet, nuk i përshkruan ato. Me forcë të rrallë artistike "A dol qymyr zotni", Nushi dhe Agla "Studenti në shtëpi", ose Bakalli "Të çelën arkapijet" e Kola "Bukën tonë të përditshme falna sot", janë dhënë personazhe të tilla. Skica dhe fejtoni e zënë pjesën më të madhe të krijimtarisë në prozë të Migjenit. Realiteti është pasqyruar me shumë larmi dhe mjeshtëri artistike në këto krijime të

rëndësishme. Migjeni herë kalon nën trajtim konkret të problemit të mjerimit, papunësisë, të mohimit të mëshirës kristiane e artit për art në prozën satirike të tij. (Një refren i qytetit tim, Mollë e ndalueme, Në kishë, Luli i vocërr, Zoti të dhashtë, etj. Shpesh humbasin kufinjt në krijimtarinë e Migjenit midis skicës e tregimit. Konflike të rëndësishme shoqërore e politike të kohës, ironia e sarkazma therëse, forma origjinale e mendimit të tij, e sidomos monologu dramatik, bëhen shprehëse të skicat e tij. Është vështirë t'i dallosh nga tregimi skicat, ku ka edhe portrete të realizuara. Një periudhë pjekurie të letërsisë sonë shënon tregimi i tij, sepse individi, në një raport të përcaktuar me jetën politiko-shoqërore filloi të vështrohej gjithnjë e më gjerë.

## IV.2. Poema e Mjerimit dhe realiteti

*"Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita*

*kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi, edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta, të tanë jetën e vet derisa të vdesin"<sup>13</sup>*

Këtë poemë Migjeni ua kushton të varfërve të cilët jetonin në kushte shumë të vështira, në skamje dhe mjerim. Për ato të cilit ishin të detyruar që të shtrijnë dorën për lëmoshë pasi nuk kishin zgjidhje tjetër. Atyre që mjerrimi iu duket në fytyrat e tyre, ngase mjerimi është i rëndë dhe nuk mund të fshihet. Ato të cilët duhej t'u luten atyre që kishin, dhe për të cilit shtriheshin sofrat të mëdha, dhe përsëri ishin të pakënaqur dhe të pangopur.

Mjerimin e jetonin në vende të errëta, të ndyra dhe të lagura, ngase edhe ato pak lekë që i fitonin, nuk iu dëlnin për jetesë në ato kushte të vështira. Dashuria e pashmërgueshme ishte një ndër mënyrat me të cilën ato shuanin etjen, ndërmjet "shërbtorët dhe lypsat", të cilët do të lindin edhe do t'i

---

<sup>13</sup>Resul Bekteshi, Xhezmi Rustemi "Gjuhë shqipe dhe letërsi III për vitet e treta të arsimit të mesëm profesional" (2010) MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

mbushin rrugët. Nëna mallkon foshnjën e saj ende pa e njohur, e mallkon fatin e keq që e ka ngase e di që foshnja e saj nuk ka asnjëfar ardhëmërie, asnjëherë nuk do buzëqeshë, po gjithë jetën do të vuajë. *"e kjo prap shtazanë , mallkon zot e dreq, mallkon frytin e vet, mallkon barrn e randë. foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon, e ama s'e don, por vetëm mallkon"*. Fëmija rritet dhe bëhet i fortë para kohe, mësohet si të përballojë jetën, jeta më të cilën mjerimi i është vërsulur që para se të fillojë. Ëndrrat fëmijërore janë shuar para kohe ngase mjerimi është i tillë, sjell një jetë të padrejtë. Si pasojë e mjerimit janë të shumtë ato të cilët bëjnë tregti edhe me trupin e tyre, jo nga dëshira por sepse nuk kanë tjetër rrugëdalje. Ia besojnë jetën e tyre që të marrin ndihmë.

Njerëzit hynë në rrugët prej të cilave nuk ka kthim, pinë që të harrojnë mjerimin i cili i ka zënë, ta harrojnë botën dhe veten. Kjo situatë nuk ka fund, as nga larg nuk shihet ndonjë ditë më e mirë, andaj në fund nuk ju mbetet asgjë më shumë se sa t'i vënë fund mjerimit, vuajtjes dhe dhimbjes.

Problemi i skamjes dhe ndikimi që ushtron është temë kryesore në poezitë "Vargjet e lira". Çfarë ndikimi ka kjo skamje në zhvillimin e jetës së njerëzve është poashtu problematikë e rëndësishme. Krijimi poetik "Poema e mjerimit" është përplot me histori dhe realitet. Një realitet i rëndë, i hidhur dhe përplot vuajtje. Duke e lexuar krijimtarinë e Migjenit, në mësojmë se çfarë jete ka pasur populli shqiptar, me çfarë sfidash të përditshme është përballur, çka është dashur të bëjë vetem që të mbijetojë. Jetë shumë të rëndë kanë kaluar paraardhësit tanë. Kjo poemë është shkruajtur në vitet e 30, është një poemë e cila na njofton me realitetin të asaj kohe, me historinë e popullit shqiptar të asaj kohe. Histori e cila na paraqet mjerimin e popullit.

Migjeni haptazi shpreh revoltën e tij ndaj pushtetit të atëhershëm zogist. Ai edhe krijon por edhe e përfaqëson epokën e asaj kohe. Nga shumë studiues të Migjenit, do ta veçojmë Mensur Raifin i cili shkruan për tiparet kryesore të Migjenit dhe ai e ndanë karakterin e shkrimtarit në tri tipare: "1. Migjeni, mësues i popullit, 2. Migjeni, poet i mjerimit, 3. Migjeni poet revolucionar"<sup>14</sup>. Këto tipare me të vërtetë e përshkruajnë dhe e përfaqësojnë karakterin e Migjenit. Ai ka qenë mësues i devotshëm i popullit të vet, ka luftuar për përparimin dhe emancipimin njerëzor. Gjithashtu edhe titulli Migjeni, poet i mjerimit, është më se i merituar

---

<sup>14</sup>Mensur Raifi, *Fan Noli dhe Migjeni*, "Rilindja", Prishtinë, 1975, f. 142.

ngase ai vuajti bashkë me popullin, e ndjente vuajtjen e tyre dhe po atë e solli te” Poema e Mjerimit”.

Ai konsiderohet edhe si revolucionar i vërtetë dhe këtë e dëshmon me kritikën e tij. Me poemën e Mjerimit ai e paraqet vuajtjen e popullit, e cila është edhe më e rëndësishme për të nga vuajtja e tij personale. E shfaq brengën tepër të madhe për brezat e ri të cilët janë të pafat dhe do trashëgojnë mjerimin ende pa filluar jeta e tyre, domethënë që në bark të nënës ndihet mjerimi. Është trishtues realiteti të cilin e kanë jetuar, dhe kjo poemë e tregon skajshmërinë e gjendjes së mjerueshme.

Poeti me poemën e tij na transferon dhimbjen që e ka ndjerë ai vet, por edhe dhimbjen e gjithë popullit shqiptar. Është e pamundur ta lexosh poemën e mjerimit dhe të mos e ndjesh dhimbjen dhe vuajtjen e tyre. Trajtim të veçantë marrin edhe dy figura shumë të rëndësishme dhe me ndikim të madh për shoqërinë, kisha dhe xhamia. Ai shpreh revoltë ndaj heshtjes së tyre. I kritikon *“therin qiellen kryqat e minaret e ngurta, profetnët dhe shejtnët në fushqeta të shumngjyrtë shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndjen tradhti”*, por edhe i akuzon për tradhti. Këtë tradhti, hipokrizinë e tyre dhe mosreagimin e tyre ai e dëshmon me realitetin që e jeton kombi, mjerim i pambarueshëm. Hipokrizia e tyre e kalon kufirin tejmasë, ngase detyra e tyre është të vihen në shërbim të drejtësisë e ato u bënë sikur nuk e shohin padrejtësinë.

Fatkeqësi njerëzore është mjerimi, dhe Migjeni ishte pjesmarrës i asaj fatkeqësie. Brez pas brezi, mjerimi vazhdonte, dhe Migjeni besonte që ky mjerim do të vazhdonte të trashëgohet edhe më tej. Sipas Migjenit duhet shumë kohë dhe mund, të kushtonte e gjithë shoqëria për ta zhdukur mjerimin. Ta çrrënjosin mjerimin. Duke e analizuar poemën e mjerimit vijmë në përfundim që kjo poemë përveç që e përfaqëson realitetin e dhimbshëm dhe një pjesë të historisë së popullit shqiptar, në të trajtohet në mënyrë të veçantë problemi i skamjes. Ai e tregon revoltën e tij, por edhe pesimizmin e tij me anë të vargjeve në të cilat shihet qartë qëndrimi i poetit për trashëgiminë e mëtejshme të mjerimit.

Artin e vet të poezisë Migjeni e paraqet si një mundim psikologjik, i cili është poashtu një shpërthim i rëndë i mundimshëm. Poezia e tij “Kangët e pakëndueshme” e shfaq atë si një rebel i cili e pasqyron veten duke u mbrojtur e duke u hapur me diellin e tij alegorik. Vetë Migjeni e shqyrton dhe e analizon se çfarë dallimi mund të bëjë poezia tij. Kangët e pakëndueshme dhe

poezitë të cilat bëjnë pjesë aty qartazi dërgojnë mesazhin e tyre të rëndësishëm dhe mesazhin i cili duhet të bëjë një zgjim, një kryengritje, një dallim ndryshues të madh.

Ai te poema e mjerimit e përshkruan mjerimin i cili është i lig, i keq, i shtyn njerëzit të bëjnë gjëra të padëshirueshme, të turpshme, megjithatë ai nuk i kritikon por i mbron ngase e di që ato nuk kanë pasur rrugëdalje tjetër. Ai me mjerimin i kritikon ato zotnitë të cilët nuk e ndjejnë, nuk e jetojnë dhe nuk e përjetojnë mjerimin. Mjerimi, sa fatkeqësi e madhe për popullin shqiptar. Shpirti i tij i mirë nuk mund të qëndrojë duarkryq ndaj kësaj situate. Edhe pse nuk ka asnjë forcë për ta luftuar, ai e përdor penën e tij si armë kundër të gjithë atyre që rrinë të heshtur dhe nuk bëjnë gjë për ta ndryshuar këtë fatkeqësi.

Po edhe titujt të tillë si: Baladë qytetse, Recital’ i malsorit, Lagja e varfun, Blasfemi, Kanga e të burgosunit, Kanga e dhimës krenare, Trajtat e mbinjëriut, Rima e tretun, Vjehsta në parakalim, përçojnë mesazhet e tyre të rëndësishme për ndryshimin e shoqërisë, por një ndryshim thelbësor. Sistemi i ideve tek këngët e kënduara, fillojnë me shpërthim por përfundojnë me terheqje. Vetminë e tij e cila nuk e le rehat, Migjeni e shfaq te kjo poemë. Vetmia nuk e le vetëm asnjë natë, dhe gjithmonë kërkon shpresë për ta shëruar shpirtin e tij të vrarë.

Poezia e tij ka një ton meditativ por diku vihet në pah forcimi i idesë, diku përshkrimi i reales dhe me siguri ëndrra e tij për të ndryshuar këtë realitet. Për herë të parë në botimin e ndaluar “Vargjet e lira” të vitit 1936 u përfshinë u publikuan në mënyrë legale te libri “Anthologji”, vol. I, në tetor të vitit 1936 d. m. th disa muaj pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia, një vit pas vdekjes së poetit. Një përllë migjeniane. Një përshkrim dhe shpërthim i dhimbjes dhe besimit. Botimet e deriatëhershme, shpjegon Migjeni, janë shumë ndjenja të pakta, nga ato që i mban në zëmrën dhe shpirtin e tij. Poezitë e tij, madhështia e tyre duhet të ndihet në shpirt.

Poezia “Këngët e pakëndueme” mbyll ciklin kuptimplotë “Këngët e ringjalljes”. Ai shprehet qartë se të gjitha që deri më tani i ka shkruar, janë vetëm një pjesë e vogël e këngëve të pakënduara, të cilat ai poashtu i quan edhe këngë të ndaluara. *"E nesërmja nuk mund të jetohej sot, kur nuk po jetohej as vet kjo e sotme. Po ato që unë dua të them, i kam thellë në veten time*



*dhe vetëm pres. Këngët dhe unë presim të shpërthejmë. Këngët dhe mua na kanë burgosur...  
“Këngët flejnë e presin një ditë ma të lumnueme”.*<sup>15</sup>

Poeti është i vetëdijshëm për talentin që e posedon, për mundësinë e tij të artistike, por është edhe i vetëdijshëm që edhe te populli është gati të shpërthejë revolucioni. Ai e njeh në thellësi karakterin e popullit tonë, energjinë e tij, gjaknxehtësinë e tij. Edhe pse poeti me shumë vargje e shpreh edhe dyshimin e tij se vallë populli ndonjëherë do të zgjohet, vallë do t'i marrë punët në duart e veta, ai pastaj e shpreh edhe shpresën edhe bindjen e tij që do të vijë një kohë më e mirë, ditë më të mira. Dhe me të vërtetë ato ditë do të vinin.

Duke u bazuar në historinë, në vitin 1936 në të gjithë botën ishte bërë i njohur lajmi për kushtetutën socialiste. Dyshimet që i shpreh Migjeni, i shpreh edhe për veten e tij duke e parë gjendjen e tij shëndetësore, ai tregon që nuk beson që do t'i arrijë ato ditë të mira që do vijnë. Për këtë shkak shkon dhe e viziton mikun e tij në Itali, A. Sh. që të japë lamtumirën dhe gjatë vizitës ai shprehet me këto fjalë: *“Me këtë shëndet që kam, nuk kam me ja arrit atyne ditëve. Për asgjë nuk më vjen keq, vetëm që unë nuk do t'i mbërrij ato ditë...”*<sup>16</sup> Me strofën e fundit poeti e shpreh dyshimin e tij, frikën e tij se mos ndoshta krijimtaria e tij do të shuhet bashkë me vdekjen e tij, me largimin e tij nga kjo botë dhe jetë e hidhur. Kjo poezi u botua pas vdekjes së tij. Në strofën e fundit dyshimi se mos ndoshta këto këngë të pakënduara do të shuhen tok me krijuesin e tyre, rritet. *“Unë i përkund këto këngë, i rrit, po ndoshta ato do të mbeten vetëm tek unë, sepse sëmundja nuk do të më lërë deri në ato ditë më të lumnueme”.* Poezia u botua vetëm pas vdekjes së poetit.

---

<sup>15</sup> Migjeni, *Vepra 4*, vep. e cit., f.270.

<sup>16</sup> Migjeni, *Vepra 4*, vep. e cit., f. ,272.

### IV.3. Migjeni dhe autorët ku mbështetet për frymëzim

Në mes të shkrimtarëve përparimtar të viteve të tridhjeta me siguri që mund të themi që bën pjesë edhe Migjeni. Këta shkrimtarë vunë bazat e letërsisë social realiste, krijues që krijuan Mbinjeri dhe për to ishte më e preferuar anarkia e mendimeve sesa bashkimi në një të pikëpamjeve dhe dëshirave. Shkodra ishte vatër e kulturës shqiptare, në kohën kur krijoi Migjeni dhe pikërisht në këtë kohë në Shkodër filloi një drejtim letrar i cili madhëronte idealizmin e jetës malësore në veriun e Shqipërisë dhe ky drejtim u quajt kleriko-katolik.

Mirëpo, për Migjenin këto ishin të tepruara ngase ai solidarizohej me vuajtjen dhe skamjen që njerëzit e jetonin, për atë dhe ai nuk e mbështeste këtë idealizëm të jetës malësore. Ai mundohej të ironizojë dhe ta shpalosë atë që shkrimtarët kleriko katolik kanë shkruar për Shkodrën dhe malësinë e saj. Dhe Migjeni po që e bën këtë me talentin e tij të jashtëzakonshëm. Pra rrjedhimisht hapësira ku i vendos ngjarjet e subjektit letrar, ku e gjen frymëzimin ky krijues është Shkodra dhe malësia e saj.

Në veprën e tij, Migjeni e bën njeriun e vogël, dhe e shpalos botën e tij të varfër por që në thelb është e pastër. Në novelat e tij paraqiten personazhe të ndryshme si përshembull Nushi i cili është student në një nga qytetet e mëdha të Evropës, dhe ky personazh paraqet zërin e arsyes, pastaj kemi Lilin, i cili e dashuron kushërirën e tij dhe thyen konvencat, më tej Lukja që detyrohet të bëhet prostitute që të mbijetojë.

Fatkeqësisht këto ëndrra të Migjenit për një botë më të mirë dhe jo me njerëz të shtypur të cilëve nuk u dëgjohet zëri, dhe më e rëndësishmja, ëndrra e tij për të krijuar Mbinjeriun i cili do të kundërvihet të gjitha gjërave të këqija dhe do t'i mbisundonte, mbetet vetëm një ëndërr, një utopi. Krijimtaria letrare e Migjenit si në poezi ashtu edhe në prozë, bëhet një zë i fuqishëm që artikulon idenë e krijimit të një shoqërie përparimtare pa tabu, pra Migjeni shpëtimin e sheh faktikisht të shoqëria si pjesë më e madhe e nacionit, ngase njëri si i vetëm ishte i pafuqishëm t'i bënte ballë rrebesheve të kohës.

Krijimtaria letrare me qëllim të paraqesë ndodhi të gjalla e të plota të kohës dhe realitetit e të cilat janë në thelb realiste, ai me këtë mënyrë reale pasqyron fatin e njeriut si individ por

edhe si kolektiv. Çfarë lloji të fatit kishte ky njëriu në shoqërinë e kohës? Ai ishte i pafuqishëm që t'i luftojë këto fenomene të shoqërisë patriarkale, ky fat i ishte imponuar nga shoqëria, këto fenomene ishin shumë denigruese për individin por edhe për të gjithë shoqërinë.

Migjeni është quajtur "poet i mjerimit", "disident", "revolucionar", etj, nga kritika e kohës, dhe të gjitha këto epitete edhe mund t'i parojnë veprës së Migjenit. Nëse shikojmë nga një këndvështrim tjetër, një këndvështrim më objektiv, me siguri që duhet ta marrim parasysh barrën e rëndë që e bart Migjeni, sëmundjen e tij e cila me siguri që reflektohet edhe në veprën e tij. Identifikimi i Migjenit me shkrimtarin e mjerimit, pa dyshim është rezultat i rrethanave në të cilat gjendej populli shqiptar në vitet tridhjeta, ky identifikim i krijuesit me mjerimin i kishte premisat e veta, ngase në veprën e Migjenit në përgjithësi parakalojnë personazhe të kamura të një ambienti të kamur.

Megjithatë, vepra e Migjenit po ashtu ka edhe karakter revolucionar, ai e paraqet mospajtimin me realitetin, revoltë, protestë, por një revoltë e brendshme që ndihet mbi kurriz të protagonistëve, por që gjithsesi reflektohet edhe në shoqëri, për atë shkak dhe identifikimi i Migjenit me shkrimtarin e mjerimit është tepër i ngurtësuar. Migjeni e shikon dhe e paraqet jetën dhe pikëpamjet e tij sidomos ndaj shoqërisë në të cilën jetonte në mënyrë irracionale. Ai tregon agresivitet të madh sidomos ndaj kishës dhe pushtetit të atëhershëm.

Migjeni ka trajtuar tematika nga më të ndryshmet, por edhe vet fakti që për shoqërinë në të cilën jetonte ai shkruan në një mënyrë shumë reale, dhe kjo është një ndër shkaqet se Migjeni është edhe në kohën tonë shumë aktual, prandaj edhe lirisht mund të themi që Migjeni është shkrimtari i parë i cili e sjell realizmin në mënyrë të artit letrar te ne shqiptarët.

## VËZHGIME PËRFUNDIMTARE

Migjeni është ndër poetet më të shquar të viteve të 30. Ai në letërsinë shqipe sjell shumë risi, për këtë shkak njihet edhe si poet novator. Është poeti i parë i cili në mënyrë të hapur shpreh impulse intime të cilat nuk kanë qenë të para në letërsinë tonë. Ai përpunon edhe shumë tematika të ndryshme si varfërinë, skamjen, rrugët në të cilat çojnë këto probleme shoqërore dhe të tjera si homoseksualizmi, edhe pse nuk ka arritur të punojë shumë në këtë sferë nga jetëshkurtësia e tij. Është mundur me gjithë shpirt të thyej shumë tema tabu. Te veprat e Migjenit shohim seksualitet të shtypur, shohim shumë figura të grave të përshkruara si nga ana fizike ashtu edhe nga ana shpirtërore. Migjeni tregon një mëshirë të jashtëzakonshme ndaj figurës së gruas.

Poezitë e Migjenit edhe pse nuk ishin të botuara në libër, kishin shumë sukses të madh. Për krijimet e tij dhe zhvillimin e tij letrar nuk mund të bëjmë një analizë shumë të gjërë dhe kritikë të plotë ngase jeta e tij ishte shumë e shkurtër dhe për këtë edhe krijimtaria e tij edhe pse për kohë të shkurtër ishte shumë domethënëse dhe veprat e tij akoma lexohen.

Vepra letrare e Migjenit është vendosur në një nga majat më të larta të letërsisë sonë kombëtare. Migjeni vdiq i ri, në moshën 27 vjeçare dhe la pas një trashëgimi letrare të paktë në sasi por me shumë vlerë të madhe.

Pas analizës së gjatë të dhënave historike në lidhje me pozitën dhe zhvillimin të gruas, jo vetëm shqiptare por edhe botërore, rrugëtimin e saj, sfidat, pengesat me të cilat është ballafaquar dhe me të cilat ende ballafaqohet, vijmë në përfundim që jeta e femrës ka ndryshuar rrënjësisht në disa aspekte fundamentale, por në disa aspekte kemi ngecje.

Pozita e femrës, por edhe e tërë shoqërisë shqiptare është ndryshuar më së shumti pasi ka filluar arsimimi i cili tek shoqëria jonë është filluar me vonesë për shkak të okupimit të gjatë. Të drejten e votës, nëse iu kthehemi të dhënave historike, do të vërejmë që si në Europë po ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gratë e kanë fituar vonë, në shekullin të kaluar, që nuk është shumë larg por shumë vonë. Por, jo rrallë, në rrjedhat e historisë, gratë janë bërë ndër faktorët më të rëndësishëm dhe me siguri që ndikimi i tyre ka qenë shumë i vlefshëm.

Gjatë shekujve të rëndë të robërisë, historia jonë kombëtare është e mbushur përplot shembuj të heroizmit të femrës shqiptare. Roli dhe kontributi i saj në periudha të ndryshme historike për lirinë e atdheut është shumë i rëndësishëm. Është fakt i pamohueshëm se femra shqiptare, duke filluar që nga periudha ilire e këndej, zë një vend të rëndësishëm në historinë kombëtare të popullit tonë.

Roli dytësor është i pranishëm edhe në këtë kohë, në kohën e demokracisë, edhe pse të gjithë duhet të jemi të barabartë dhe gratë shumë më pak e ndjejnë demokracinë e vërtetë. Si e drejtë njerëzore është edhe e drejta për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse e jo gratë të jenë veç numër apo kukull për argëtimin e politikanëve.

Në të gjitha fushat e veprimit ekonomik, politik, shoqëror por dhe të tjera, gruaja filloi të kërkojë të drejtat e saj për t'u realizuar dhe për t'u barazuar me gjininë mashkullore në të gjitha aspektet. Por, për shkak të paragjykimëve të cilat akoma nuk janë shuar tërësisht, për egoizmin, për shkak të luftës për pushtet, prepotencës mashkullore, këto të drejta realizohen pjesërisht dhe me një tempo shumë të ngadaltë.

Në etapat e zhvillimit njerëzor, më të rëndësishme janë etapat e shpirtit njerëzor gjatë historisë, dhe një rol të veçantë dhe të rëndësishëm për këtë, ka patur dhe ka prania e gruas në mbare shoqërinë njerëzore. Çdo ditë e më shumë ndodhemi përballë shumë sfidave dhe fenomeneve që shoqëria e sotme po i shfaq me shumë agresivitet. Që kur është krijuar universi e deri në kohën tonë figura femërore ka patur një peshë të madhe, dhe pasqyrohet më së shumti në veprat artistike.

Në veprën e Migjenit, gruaja është simbol i dhimbjes, në një shoqëri ku dinjiteti i saj nëpërkëmbet, ai me veprat e tij përpiket t'i thyejë konceptet e vjetëruara. Duke analizuar

personazhin e gruas te veprat e Migjenit, vijmë në përfundim që prania në këtë botë nuk është një ëndërr, por që femrat jetojnë dhe vdesin duke iu përlurur hipokrizisë njërëzore.

Duke u mbështetur në të gjitha të dhënat historike, por edhe në analizën e përsnazhit të gruas te prozat e Migjenit nxjerrim përfundimin që Migjeni dëshiron flakshëm lirim in e njëriut nga patriarkalizmi, moralin e rrejshëm dhe emancipimin e mentalitetit të prapambetur. Tani shikohet qartë lëvizja e lirë e femrës në ambientet sociale, të punës, politikës, ekonomisë, gjë që paraqet dhe tregon për prezencën dhe pjesmarrjen e gruas në shoqërinë shqiptare, që është rritur ndjeshëm. Mentaliteti gjithsesi akoma nuk ka ndryshuar ngase barazia e plotë ndërmjet gruas dhe burrit akoma nuk është e arritur në shoqërinë shqiptare, dhe e gjitha kjo për shkak të tipareve tradicionale patriarkale. Zhvillimet kulturore dhe evoluimi i shpirtit të njerëzve janë gjëja më parësore nga e cila varet roli i gruas shqiptare në shoqëri.

## BIBLIOGRAFI

1. Aliu, Ali "Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit" Prishtinë (1980).
2. Aliu, Ali "Rrjedhave të letërsisë-Rilindja" Prishtinë (1977).
3. Ali Aliu, Kritikë, "Rilindja", Prishtinë, (1977).
4. Arifi, Teuta " Feminizmi ekzistencialist" (1997).
5. Alili- Rexhepi, Zejnepe " Gruaja te Migjeni dhe Floberi" (2011).
6. Çapriqi, Basri: "Simbolika e një qyteti", Prishtinë, (1998).
7. Dado, Floresha: Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë, 2006, fq. 195
8. Demir, Zekije " Feminizmi modern dhe postmodern" (1997).
9. Demo, Elsa "Migjeni në librin e shtëpisë"(14 Tetor 2011).
10. Dora D'Istria. Shqiptarët në Rumani. Historia e princërve Gjika në shekujt XVII, XVIII, XIX. Tiranë, 2015.
11. Elsie, Robert " Albanian Literature: A Short History" (2005).
12. Fetiu, Sefedin "Vepra e Migjenit dhe kritika e saj" Prishtinë (1984).
13. Fotaq Andrea. Pena të arta franceze për shqiptarët. (1332-2007). GentPrint, Tiranë:2009).
14. Frasheri, Kristo " Rilindja Kombëtare Shqiptare" (1962).
15. Mensur Raifi, Fan Noli dhe Migjeni, "Rilindja", Prishtinë (1975).

16. Millosh, Gjergj- Migjeni " Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriut" (2009).
17. Petro Janura "Migjeni-Flaka e Vëllazërimit" Shkup (1979).
18. Pipa, Arshi "Albanian literature: social perspectives "(1978).
19. Pipa, Arshi " Për Migjenin" (2006).
20. Resul Bekteshi, Xhezmi Rustemi "Gjuhë shqipe dhe letërsi III për vitet e treta të arsimit të mesëm profesional"Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë (2010)
21. Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, “Dukagjini”, Tiranë – Pejë (1997).
22. Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, “Albas”, Prishtinë (2005).



## **BURIME NGA INTERNETI:**

1. [https://filologjiku.uni-gjk.org/upload/dokumentet/1568015670-Fortesa%20Alimusaj\\_Punim%20Diplome.pdf](https://filologjiku.uni-gjk.org/upload/dokumentet/1568015670-Fortesa%20Alimusaj_Punim%20Diplome.pdf) (08.05.2020)
2. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Migjeni> (08.05.2020)
3. <http://www.albaniapress.com/lajme/13675/Migjeni-%E2%80%93-rrenues-i-tabuve---.html> (08.05.2020)
4. [https://sq.wikibooks.org/wiki/Vitviteja/MIGJENI/Alfred\\_Uci](https://sq.wikibooks.org/wiki/Vitviteja/MIGJENI/Alfred_Uci) (29.04.2020)
5. <https://www.epokaere.com/roli-gruas-shqiptare-nder-vite/> (15.04.2020)
6. <http://www.gazetadita.al/fillesat-e-pasqyrim-it-gruas-shqiptare-ne-kulturen-europiane-ne-shekullin-e-xix/> (10.04.2020)
7. <https://www.radiokosovaelire.com/elif-luzha-gruaja-shqiptare-dhe-sot/> (05.04.2020)
8. <https://përqasje.com/2016/03/roli-i-gruas-ne-shoqërine-shqiptare/> (28.03.2020)
9. [https://prezi.com/8zwm\\_pr76z92/gruaja-shqiptare-ne-vitet-20039/](https://prezi.com/8zwm_pr76z92/gruaja-shqiptare-ne-vitet-20039/) (07.04.2020)
10. <https://www.fletarinews.com/2018/11/proza-e-migjenit.html> (20.04.2020)